




BASHKËPUNIMI



Konsolidohet programi me Gardën e New Jersey-it

Zv/ambasadori Amerikan në Shqipëri z. Henri Jardin, vizitë në KDS, në kuadrin e programit pilot të arsimimit e trajnimit të oficerëve të rinj të FARSH me Gardën Kombëtare të New Jersey

faqe 2

STRATEGJIA

Refleksione në kuadrin e përgatitjes së Strategjisë së Sigurisë Kombëtare

Aspekte të sigurisë së vendit tonë - dimension ushtarak i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të RSH-së

faqe 4

ANALIZA

QNOD ballafaqohet me realizimin e detyrave të vitit 2013

faqe 6

NATO



Konferencë për shtyp pas takimit të shefave të Mbrojtjes për 2014

Pyetje dhe përgjigje pas konferencës së përbashkët për shtyp nga gjenerali Knud Bartels, gjenerali Philip M. Breedlove dhe gjenerali Jean-Paul Palomeros

faqe 3

FORCA AJRORE

Ministrja Kodheli inspekton Bazën Ushtarake në Gjadër, Lezhë

Ministrja Kodheli ka vizituar mjediset e Bazës Ushtarake Ajrore në Gjadër, ku u njoh me gjendjen dhe infrastrukturën e tuneleve, në të cilat ndodhen 32 avionë Mig që janë jashtë funksionit prej disa vitesh



faqe 2

“EAGLE 8” NISËT DREJT AFGANISTANIT

Vazhdon kontributi shqiptar i kthyer në ritual



faqe 8-9

VEPRIMTARI PËRKUJTIMORE

Një këndvështrim për Ismail Qemalin



QLMI-ja organizoi një veprimtarinë “Isamil Qemali – Kryeministri i Parë i shtetit shqiptar”, në kuadrin e 170 vjetorit të lindjes (16 janar 1864) dhe 95 vjetorit të vdekjes (24 janar 1919). Qëllimi ishte të njihej jeta, puna dhe veprimtaria e bërë nga Ismail Qemali për shtetin shqiptar dhe FA nëpërmjet studimit të librave të botuara...

faqe 12-13

DEMONTIMI

Përfundon me sukses certifikimi i Grup-Depove të Murrashit, Elbasan

faqe 7

FORCA TOKËSORE

65 ushtarakë të Forcave Tokësore, fillojnë kursin e gjuhës Angleze

faqe 11

ANO

ANO, në fokus arsimit dhe bashkëpunimi me britanikët

faqe 13

DOSSIER



Shqipëria e Luftës së Ftohtë në dokumentet Sekrete të NATO-s

1958, raporti i parë i Inteligjencës së SHAPE mbi nëndetëset e Vlorës: “Në vijim është një ekstrakt nga një Raportit Përmbledhës i kohëve të fundit i Inteligjencës së SHAPE-s, dhe është sjellë për informim...”

faqe 14

Ministrja e Mbrojtjes Kodheli inspekton Bazën Ushtarake në Gjadër, Lezhë

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, në datën 27 janar 2014, ishte për inspektim në Bazën Ushtarake Ajrore në Gjadër, Lezhë. Gjatë këtij inspektimi ministrja Kodheli shoqërohej nga komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Frederik Beltoja. Fillimisht, ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli është informuar mbi gjendjen e Bazës Ushtarake në Gjadër si dhe me problematikat që ka aktualisht kjo bazë. Më pas, ministrja Kodheli pa nga afër mjediset e Bazës Ushtarake Ajrore në Gjadër, si dhe ka



takuar ushtarakët dhe punonjësit e saj. Në vijim, ministrja Kodheli ka vizituar mjediset e Bazës Ushtarake Ajrore në Gjadër, ku u njoh me gjendjen dhe infrastrukturën e tuneleve, në të cilat ndodhen 32 avionë Mig që janë jashtë funksionit prej disa vitesh.

Përkujtohet Dita Ndërkombëtare e Holokaustit

Këto ditë, në ambientet e KDS-së u organizua nga QLMI një veprimtari përkujtimore për ditën ndërkombëtare të Holokaustit. 27 janari është një ditë e përzgjedhur nga Asambleja e Kombeve të Bashkuara për nder dhe kujtim të viktimave të Holokaustit, në mbyllje të kampeve të përqendrimit dhe fundin e Holokaustit. Kjo ditë përkufizohet si shkatërrim apo masakrim në masë, i shkaktuar nga regjimi nazist gjerman gjatë Luftës së Dytë Botërore, në të cilën u torturuan dhe u vranë 6 milionë çifutë. Kjo ditë ndërkombëtare është përzgjedhur si ditë përkujtimore ndaj viktimave të gjenocidit të Holokaustit dhe është një ditë ku rishpallen angazhimet tona për të mbrojtur të drejtën e jetës dhe të njeriut, duke dënuar të gjitha shprehjet e intolerancës fetare apo asaj në bazë origjine dhe etnie. Në këtë datë brezat e rinj duhet të dinë këtë histori dhe ta dënojnë atë. Kolonel Zaho Golemi, gjatë këtij aktiviteti u shpreh se si institucione ushtarak kontaktet e para me djem të popullit të martirizuar hebre dhe të goditur nga disa perandori deri tek Rajhu III, i kishte pasur në vitin 2007, kur katër djem ushtarak izraelit morën pjesë në stërvitjen ushtarake të zhvilluar në Shqipëri "Cooperativ Longbow/Lancer 2007. Ata përcolën tek ne virtytet më të spikatura të hebrenjve: të mençur, praktikë, bashkëpunues e miqësorë. Ishin si të thuash "motorë" në këtë stërvitje multinacionale mes miqsh e partnerë strategjik në fushën e sigurisë. Kështu nga specialistja e QLMI-së Anita Pacani u shfaq materiali i gërshtuar në një video dhe dokumentacionin e marrë nga arkivat e vendit tonë në bashkëpunim me Shoqatën e Historianëve Ushtarakë. Në materialin e përgatitur tregohet se në Evropë hebrenjtë trajtoheshin ndryshe në vitet '40 të shek. XX, më konkretisht në Gjermaninë naziste, ku filloi dhe fushata anti-Semite. Ndryshe në Shqipëri ata ishin si në shtëpinë e tyre. Fotot në Tiranë, Kavajë e Elbasan me familjet e tyre flasin për një gëzim dhe liri të drejtave të tyre. Komisariati i Lartë për Refugjatë të Lidhjes së Kombeve, si dhe një numër bashkësishe hebraike në botë, i drejtuan sytë nga Shqipëria për të prurë këtu qindra familje hebrenjsh. Këtë e tregojnë dokumente që gjenden në AQSH duke filluar që nga vitin 1935... Shteti shqiptar kishte evidencë të saktë për hebrenjtë në Shqipëri. Kjo tregon përkujdes ndaj evidentit të saktë të tyre... Në vitet 1938-1939 në Shqipëri erdhën rreth 200 hebrenj nga Gjermania, Austria, Franca, Polonia, Hungaria etj., dhe u vendosën në Tiranë, Durrës, Korçë etj. Në këtë kohë u bë dhe regjistrimi i tyre i përgjithshëm, në prill të vitit 1939, i cili u pasua dhe në vitet 1941 e 1943. Konferenca e Vansees (Wansee) më 20 janar 1942 vendosi shfarosjen e hebrenjve në të gjitha vendet e pushtuara nga nazistët. Gjendje veçanërisht e rëndë u krijua për hebrenjtë në Prishtinë që rrezikonin të binin në duart e nazistëve. Në opinionin shqiptar u krijua një shqetësim i thellë. Një pjesë e mirë me urdhra shoqërimi të qeverisë shqiptare u sollën në Shqipëri. Kontingjenti i parë prej 100 vetash u vendos në Berat më 5 prill 1942, kontingjenti i dytë prej 79 vetash u vendos në Fushë-Prezë dhe kontingjenti i tretë prej 69 vetash u vendos në Krujë, Shijak, Kavajë dhe Burrel. Të tjerë erdhën ilegalisht dhe me dokumente false. Në verën e vitit 1943 numri i tyre në Shqipëri shkante mbi 1.000 veta. Populli shqiptar i strehoi dhe i mbrojti Hebrenjtë nga viktimizimi dhe shfarosja e nazistëve. Në veprimtari morën pjesë drejtues të institucioneve, akademikë, kursantë, pedagogë të AFA, civilë etj.

Elina Laçi

Konsolidohet programi me "Gardën Kombëtare të New Jersey-it"

Zv/ambasadori Amerikan në Shqipëri z. Henri Jardin, vizitë në KDS, në kuadrin e programit pilot të arsimimit e trajnimit të oficerëve të rinj të FARSH me Gardën Kombëtare të New Jersey

Në kuadrin e programit pilot të trajnimit të oficerëve të rinj të FARSH, të iniciuar në muajin shtator të vitit të kaluar, bëri një vizitë në institucionin e KDS, zv/ambasadori Amerikan në Shqipëri z. Henri Jardin. Në vizitën e tij, zv/Ambasadori Jardin, shoqërohej nga shefi i zyrës së ODC, major Christopher Mitchell. Zv/ambasadori Amerikan, Henri Jardin, u prit në një takim të veçantë nga zv/komandanti i KDS, Kolonel Ruzhdi Kuci. Në takim morën pjesë drejtori i Drejtorisë së Arsimimit dhe Përkujdesjes Sociale të Ushtarakut në MM, Kujtim Kadzadej, rektori/komandanti i AFA kolonel Prof. As. Dr. Agim Sula, si dhe stafi mbështetës i institucionit të KDS, përgjegjës për trajnimin e kontingjentit të ushtarakëve shqiptarë sipas standardeve trajnuese të Gardës së New Jersey. Kolonel Kuçi, pasi uroi mirëseardhjen, shprehu vlerësime për rritjen e bashkëpunimit me SHBA, në fushën e arsimimit ushtarak. "Përgatitja e ushtarakëve tanë nëpërmjet këtij programi pilot, përveçse rritjes së aftësive profesionale, rritjes së ndërveprueshmërisë së trupës ushtarake, do të ndikojë ndjeshëm edhe në rritjen e imazhit të Forcave tona të Armatosura-ka theksuar ndër të tjerash, kolonel Kuçi". Nga ana e tij, zv/ambasadori Amerikan në Shqipëri, Z. Henri Jardin, pasi falënderoi për mikpritjen, shprehu vlerësime pozitive për rritjen e bashkëpunimit dypalësh, gatishmërinë e një pune të përbashkët, midis Zyrës së ODC në MM, atashut



ushtarak amerikan dhe palës shqiptare, për realizimin me efikasitet të fazave trajnuese të programit. "Jam i lumtur që edhe vetë Ministrja e Mbrojtjes, znj. Kodheli, në fillimet e punës së saj, nënshkroi "Letrën e Ofertës e Pranimit" ndërmjet MM të RSH dhe Gardës Kombëtare të New Jersey, si konkretizim i b/punimit në kuadrin të "State Partnership". Të dy palët jemi më se të interesuar që gjithçka të shkojë mirë e sipas planifikimit të standardizimit-është shprehur Z. Jardin". Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, si institucioni kryesor i sistemit të edukimit, arsimimit dhe trajnimit të FA, mban peshën kryesore në aplikimin dhe realizimin e këtij programi. Në këtë kuadrin, kolonel Kuçi e njohu Zotin Jardin me gjendjen aktuale të zhvillimit të kursit, masat e marra nga ana e institucionit të KDS dhe strukturave të varësisë së saj, në drejtim të përzgjedhjes së trupës së instruktorëve dhe kandidatave pjesëmarrëse në këtë program,

hartimit të programit trajnues, masave mbështetëse logjistike e infrastrukturore për akomodim, jetesë, përgatitje fizike e bazë materiale didaktike e kancelarike. Rektori/komandanti i AFA kolonel Prof. As. Dr. Agim Sula, shprehu angazhimin maksimal të të gjithë strukturave arsimore, në mbështetje efikase të realizimit me sukses të të gjitha fazave të programit trajnues, përgjatë gjithë kohës së zhvillimit të tij, duke theksuar se ecuria pozitive e këtij trajnimi, si i pari i këtij lloji, do të shërbejë si guidë orientuese për të ardhmen, në funksion të përshtatjes e standardizimit të trajnimeve të mëtejshme jo vetëm me Gardën Kombëtare të New Jersey, por dhe me FA të vendeve të NATO-s. Zv/ambasadori Amerikan në Shqipëri z. Henri Jardin dhe ekipi që e shoqëronte, vizitoi në të pastajmen ambientet ku aktualisht po zhvillohet programi trajnues, si; Qendrën e Gjuhëve të Huaja, ambientet e akomodimit, stërvitjes, ambientet mësimore etj.

STAFI

Gazetarë:
Ermal Kaçaniku
Alba Musaraj
Leonard Quku

Redaktore korrektore:
Elona Shimaj Mako

Graphic Designer:
Afërdita Hysaj

Konferencë e përbashkët për shtyp pas takimit të parë së shfave të Mbrojtjes për vitin 2014

Pyetje dhe përgjigje pas konferencës së përbashkët për shtyp nga gjenerali Knud Bartels (kryetar i Komitetit Ushtarak të NATO-s), gjenerali Philip M. Breedlove (komandant Strategjik i Aleatëve në Europë) dhe gjenerali Jean-Paul Palomeros (komandant Strategjik i Aleancës për Transformim)

Kapiteni (n) Dan B. Termansen (Zëdhënësi i Komitetit Ushtarak): Kemi rreth 10 minuta kohë për pyetje dhe siç e përmenda më parë, ju lutem jepni emrin tuaj dhe të agjencisë që ju përfaqësoni. *Pyetje, Adrian Croft nga Reuters. Kam dy pyetje për gjeneral Breedlove, ju lutem nëse është e mundur. Njëra është në lidhje me Afganistanin; qeveria afgane ka prezantuar kushtet e reja në negociatat me NATO-n për Marrëveshjen e Status Quosë së Forcave pas misionit të vitit 2014. A është ky një shqetësim për ju dhe a mendoni se tani ka më shumë mundësi që forcat amerikane dhe ato të NATO-s të largohen tërësisht nga Afganistani pas vitit 2014 dhe pyetja e dytë është a ka kërkuar Rusia ndonjë ndihmë nga Amerika ose NATO në drejtim të ofrimit të sigurisë për Lojërat Olimpikë të Soçit.*

Kapiten (n) Dan B. Termansen: General Breedlove. **General Philip M. Breedlove (komandant Strategjik i Aleatëve në Europë):** Në fillim kalojmë tek pyetja e BSA (Marrëveshja Dypalëshe e Sigurisë Afgane). Ka shumë diskutime në vazhdim e sipër mbi BSA dhe nuk do të karakterizoj se cilat janë ato apo nëse ka kushte të reja. Në mënyrë të qartë, diskutimi është në vazhdim. Ajo që është e rëndësishme është që sa më shpejt të kemi BSA, aq më mirë do të jetë, por ne do të mbetemi fleksibël dhe në gjendje të përshtatemi me kohën dhe marrëveshjen kur ta kemi atë. Për të pozicionuar më mirë forcat tona, në mënyrë që të sigurojmë më mirë ata që po dhurojnë, aq më shpejt do të kemi një BSA dhe aq më mirë do të jetë.

Për sa i përket çështjes së Rusisë, ka pasur biseda të vazhdueshme ndërmjet Rusisë dhe shumë vendeve rreth Olimpiadës. Siç keni dëgjuar, kemi rënë dakord të flasim për disa nga aftësitë kundër IED dhe të tjerave. Nuk do të lexoj në mënyrë specifike çdo detaj, por ne do të jemi bashkëpunues me vëllëzërit e motrat tona ruse, ndërkohë që ata do të drejtojnë këtë Olimpiadë. Kam pasur një takim me gjeneral Gerasimov dhe shkëmbyem informacion si dhe mënyrat me të cilat do të komunikojmë rreth Olimpiadës dhe këtë e shoh si një zhvillim shumë pozitiv.

Kapiten (n) Dan B. Termansen: Pyetja tjetër ju lutem. *Pyetje, Nawab Khan nga Agjencia e Lajmeve së Kuvajtit, KUNA. Gjenerali Bartels filloi diskutimet me partnerët e Mesdheut. A u ngrit çështja e Sirisë dhe në vendet e tjera rajonale? Pyetja e dytë është: A ishin të fuar partnerët e Inicjativës së Bashkëpunimit të Stambollit?*

Kapiten (n) Dan B. Termansen: Gjeneral Bartels. **Gjeneral Knud Bartels (kryetar i Komitetit Ushtarak të NATO-s):** Në lidhje me pjesën e fundit të pyetjes së dytë, ishin ekskluzivisht vetëm partnerët



e Dialogut të Mesdheut që ishin prezentë dhe në kuadër të diskutimit rreth situatës së Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut, ne diskutuam rreth krizës në Siri, ku na u paraqitën perspektivat nga kombet e afërta me të.

Kapiten (n) Dan B. Termansen: Pyetja tjetër.

Pyetje, Khalid Hameed Farooqi nga Televizioni i Lajmeve GEO, Pakistan. Gjenerali, Pentagoni lëshoi një deklaratë se do të ketë 10.000 trupa që do të mbesin pas vitit 2014, nëse arrihet një marrëveshje ndërmjet qeverisë afgane dhe NATO-s. Përndryshe, nuk do të ketë asnjë, sepse kjo do të jetë një arsye që lufta dhe rezistenca të vazhdojnë. A është ky një zhvillim shqetësues për amerikanët që lëshojnë një deklaratë të tillë? A do të ketë ushtarë të NATO-s apo të huaj në Afganistan?

Gjenerali Knud Bartels: Më lejoni të theksoj dy gjëra këtu. E para që u përmend në mënyrë të tërthortë nga gjenerali Breedlove, është se dhe ne nuk e kemi dëgjuar se çfarë do të ndodhë në vitin 2014. Kemi ende 11 muaj përpara, të cilët janë shumë të rëndësishëm. Së dyti, siç e theksoi dhe gjenerali Breedlove, ne po e vazhdojmë planifikimin tonë. Ne jemi fleksibël dhe të shpejtë e do të jemi të gatshëm të përshtatemi kur të vijë vendimi. Po qëndrojmë në këtë fazë, e cila mbështetet plotësisht nga të gjithë shefat e Mbrojtjes së NATO-s dhe partnerët e ardhshëm të misionit Resolute Support (Mbështetje e Vendosur).

Kapiten (n) Dan B. Termansen: Zonjë.

Pyetje, Teri Schultz me NPR dhe CBS. Sa fleksibël mund të jeni ju nëse procesi i negociatave së buxhetit në shtetet anëtare dhe aleatët mbaron dhe nuk merret asnjë vendim në lidhje me BSA? Sa fleksibël mund të jeni me forcat nëse nuk keni një buxhet për misionin post 2014? A nuk është e pamundur për ta bërë këtë pa asnjë fond të ri?

Gjenerali Knud Bartels: Përsa i përket këtij dimension, do të thoja se kjo është individuale për çdo shtet dhe çdo vend ka procedurat e tij individuale. Shefat e Mbrojtjes e përdorin këtë mundësi për të

shprehur mbështetjen e tyre të plotë dhe janë të gatshëm të qëndrojnë fleksibël në të ardhmen për t'ju përshtatur politikës së vendimmarrjes së misionit Resolute Support dhe do të shohim se cili do të jetë rezultati i Ministerialit të Mbrojtjes, i cili do të zhvillohet në muajin shkurt.

Kapiten (n) Dan B. Termansen: Kemi një pyetje tjetër.

Pyetje, Takashi me Transmetimin NHK. Vetëm një vazhdimësi për të njëjtat çështje. Nuk shoh ndonjë afat që keni caktuar rreth marrëveshjes për forcat. Cili do të jetë afati i fundit?

Gjenerali Knud Bartels: Duhet të kemi parasysh që jemi vetëm në muajin janar të vitit 2014 dhe kemi akoma 11 muaj përpara e siç e përmenda pak më parë, ne po fokusohemi jo vetëm në rezultatin e kësaj fushate. Ne duhet të sigurohemi që mund të përshtatemi dhe do të presim udhëzimet e mëtejshme politike dhe kjo qasje mbështetet plotësisht jo vetëm nga mjeshtrit tanë politikë, por edhe nga shefat e Mbrojtjes.

Kapiten (n) Dan B. Termansen: Gjeneral Breedlove, keni diçka për të shtuar?

Gjeneral Philip M. Breedlove: Do të doja të shtoja diçka që mund t'ju ndihmojë të kuptoni fleksibilitetin rreth të cilit bisedoi CMC (kryetari i Komitetit Ushtarak). Siç e përmendi dhe ai, kemi akoma 11 muaj përpara dhe gjatë këtyre muajve do të realizohet shumë me ANSF (Forcat e Sigurisë Kombëtare Afgane). Mjaft përparime tashmë janë bërë. Ne kemi 11 muaj për t'u marrë me gjëra mbi të cilat duhet punuar, por gjatë kësaj kohe, ne do të fillojmë të tërheqim gradualisht forcat e trupat tanë. Kështu, do t'i fillojmë më herët diskutimet rreth buxhetit. Ne po gjurojmë se cili mund të jetë numri që presim nga misioni Resolute Support dhe shpresojmë që të jemi plotësisht në misionin e trajnimit, këshillimit dhe ndihmës që nga mesi i vitit 2014, pavarësisht parashikimit të tetorit të vitit 2014. Kështu, ky proces fillon gjatë vitit të ardhshëm ndërkohë që ne vazhdojmë të punojmë me partnerët tanë afganë për të zhvilluar aftësitë për

të cilat ata kanë nevojë.

Kapiten (n) Dan B. Termansen: Pyetja tjetër ju lutem.

Pyetje, Ana Pisonero nga Agjencia e Lajmeve Spanjolle, Europa Press. Mendoj se është për gjeneralin Palomeros lidhur me stërvitjen e lartë të dukshme që kryesisht do të presë Spanja, stërvitja e menaxhimit të krizave. A mund të na jepni më shumë detaje, do të jetë vetëm Forca e Reagimit të NATO-s që do të testohet? Ose cilët janë elementët kryesorë? Gjithashtu, nuk e di nëse e kuptova saktë, se ne kemi tashmë 20.000 trupa që do të marrin pjesë. Në fakt, kuptuam se do të jetë një stërvitje më e madhe, pothuajse dyfish, apo dhe më shumë se sa forca që ju përmendët.

Gjenerali Jean-Paul Palomeros (komandant Strategjik i Aleancës për Transformim): Kjo është e sigurt. Ne kemi tre vende vullnetare dhe kjo është pothuajse një arrihtë dhe falë angazhimit të Spanjës, Portugalisë dhe Italisë, kemi një tablo të duhur për vendosjen e kësaj stërvitjeje. Së pari, ky është një lajm i mirë. Së dyti, Spanja dhe vendet e tjera pritëse kanë ofruar tashmë mjaft lehtësira dhe ne po kërkojmë mjedis të butë ajror dhe tokësor. Në thelb, do të jetë një stërvitje e përbashkët. Ne do të përpqemi të përfshijmë mësimet që kemi mësuar gjatë dy dekadave operacionesh. Pra, do të jetë një ngjarje kyçe në termin e vlerave të larta për njerëzit, të cilët do të trajnohen e ushtrohen nëpërmjet stërvitjes. Forca e Reagimit të NATO-s do të jetë një aktor kyç në këtë, por nuk do të jetë e vetmja dhe ne do të përpqemi të lehtësojmë ndërveprimin midis Forcës së Reagimit të NATO-s dhe forcave të tjera kombëtare të cilat kontribuojnë në nivelin e ambicies së NATO-s në një nivel të lartë stërvitjeje, e cila ilustron shumë mirë krizat e sotme. Skenari do të përshtatet me mbrojtjen raketore balistike, kibernetikën dhe shumë aspekte të tjera. Përsa i përket numrave, ato janë numra të përafërt, por duhet të fokusohemi tek cilësia. Jam i sigurt se do të arrijmë një nivel të lartë të përfshirjes së kombeve. Disa vende e kanë deklaruar angazhimin e tyre, por ende jo me shifra. Ne jemi fokusuar tek aftësitë kritike, tek

ajo që shohim kritike në menaxhimin e ri të krizave. Këtu citoj inteligjencën, mbikëqyrjen dhe zbulimin. Ne jemi në kërkim të dronëve (avionë të telekomanduar). Jemi në kërkim të furnizimit me anë të ajrit si dhe aftësi nga deti. Ne duam ta bëjmë këtë realitet dhe efektive.

Kapiten (n) Dan B. Termansen: Një pyetje tjetër të shkurtër.

Pyetje, Jan Kordys nga Agjencia Europiane. Sesioni i parë i takimit tuaj ishte rreth Dialogut të Mesdheut dhe në e-mailin që morëm para takimit thuhej se do të ishte rreth progresit të bashkëpunimit praktik. Nuk e di nëse kishte bashkëpunim praktik brenda këtij Dialogu, por nëse kishte, a mund të thoni diçka rreth kësaj dhe ku mendoni se ka një progres të mundshëm? Pyetja e dytë është për gjeneralin Breedlove në lidhje me Ocean Shield (Mburoja Oqeanike). Cila është e ardhmja e këtij misioni? BE-ja po mendon të zgjasë mandatin rreth dy vjet, por gjithashtu të zgjerojë veprimin e mundshëm në luftën kundër peshkimit të paligjshëm. A mendoni se mund të bëjë NATO të njëjtën gjë?

Gjenerali Knud Bartels: Rreth pyetjes së parë, Dialogu i Mesdheut po kërkon një numër lidhjesh me të cilat të veprojë. E para, sigurisht, Aleanca me Dialogun e Mesdheut si një e tërë, është një çështje dialogu dhe shkëmbimi pikëpamjesh, informacionesh dhe krijim i një kuptimi më të mirë. Pastaj ka një bashkëpunim të Aleancës me anëtarët individualë të Dialogut të Mesdheut. Së fundi, ekziston një numër aleatësh, marrëdhëniesh dypalëshe apo shumëpalëshe dhe bashkëpunimi me kombet në fjalë. Ne duam t'i forcojmë të gjitha këto dhe të jemi lehtësues aty ku është e nevojshme.

Kapiten (n) Dan B. Termansen: Gjeneral Breedlove.

Gjeneral Philip M. Breedlove: Përsa i përket çështjes së operacionit Ocean Shield, përgjigja është po, ai do të vazhdojë. Ai është një nga operacionet më të suksesshëm, siç e dini. Praktikisht, ai ka eliminuar piraterinë në Bririn e Afrikës. Ne nuk do të mund ta eliminojmë kurrë plotësisht piraterinë. Kjo ka vazhduar për mijëra e mijëra vjet, por pirateria është reduktuar në nivelet më të ulëta historike. Nëse nuk vazhdojmë t'i kushtojmë rëndësi, ajo do të rikthehet. Pra, pres që Ocean Shield të vazhdojë për disa kohë. Gjithashtu, ai është një shembull i mrekullueshëm ku partnerët tanë kanë luajtur rolin të madh në të. Vendet partnere, duke përfshirë Ukrainën, kanë marrë pjesë në Ocean Shield dhe kanë dhënë një kontribut mjaft të rëndësishëm. Ne filluam një bisedë rreth pjesës së dytë të pyetjes në lidhje me përshtatjen e misionit, por nuk janë marrë vendime dhe do të këshillojmë trupin tonë politik në lidhje me mendimet tona si ushtarakë se cila do të jetë e ardhmja e atij operacioni.

Kapiten (n) Dan B. Termansen: Me këtë, përfundon dhe konferenca për shtyp. Ju faleminderit të gjithëve për pjesëmarrjen!

Aspekte të sigurisë së vendit tonë - dimension ushtarak i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare

Refleksione në kuadrin përgatitjes së Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të RSH (SSK)

NGA: N/KOL. (R) KANAN HIMAJ,
Qendra Kombëtare e
Sigurisë dhe Mbrojtjes

Realitetet udhëheqin sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare, bazuar në kapacitetin e parandalimit dhe sidomos veprimet aktive në kohë ndaj krizave, kërcënimeve dhe rreziqeve. Mjetet e veprimit përbëhen nga udhëheqja e strategjisë së sigurisë, ku qëllimi është mbrojtja e vlerave, interesave kombëtare dhe ndërkombëtare. Strategjia e Sigurisë mund të vlerësohet si efektive kur, pas një rreziku, vendi nuk vuan humbje të mëdha dhe periudha e rimëkëmbjes është e shkurtër. Siguria Kombëtare ka për qëllim mbrojtjen, duke përdorur integrimin e strategjisë së sigurisë me objektivat të përcaktuara që duhet të arrijë. Tashmë, drafti i parë i SSK është një realitet dhe i vlerësuar nga pjesa elitë akademike, intelektuale, profesionistë që kanë arsimimin e nevojshëm brenda dhe jashtë vendit që kuptojnë drejtimit politike, objektivat, konceptet, qëllimet për një qasje të balancuar duke përfshirë disa fusha të ndjeshme, shtrirjen strategjike për drejtimit kryesor strategjike të NATO-s dhe BE-së dhe qëndrueshmërinë në promovimin e interesave kombëtare dhe ndërkombëtare. Në qendrat studimore dhe kërkimore të sigurisë, shoqëritë akademike ose në qendrat kryesore të vendim-marrjes të sigurisë ka tendencë pozitive që të trajtohen çështjet që lidhen me interesin kombëtar dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar për sigurinë e integritetin, rreziqet dhe kërcënimet në nivelet kombëtare, rajonale dhe globale. Analiza në këto qendra, siç është Qendra Kombëtare e Sigurisë dhe Mbrojtjes ka vlerësuar me kujdes çështjet e sigurisë të cilat shtrihen në shumë aspekte, por në veçanti përfshin drejtimit politike për zhvillim, aftësitë dhe qëllimet e vendit tonë në rritjen e rolit në rajon e më gjerë. Ajo ka trajtuar mjedisin e tanishëm i sigurisë së vendit, i cili shfaqet nga ndryshime të thella në fushat kyçe të jetesës shoqërore: si një vend anëtar i NATO-s dhe kandidat për në BE-në. Në të njëjtën kohë, vendi ynë po vlerëson seriozisht kërcënimet e zhvilluara shumë kohët e fundit në sigurisë e vendit dhe atë globale ku mund të përmendim fenomenin e terrorizmit në vend, krimin e organizuar



në fushën e sigurisë, (jetës shoqërore, ekonomisë etj), përhapjen dhe përdorimin lëndëve narkotike dhe mungesën e vëmendjes ndaj kontrollit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë.

Kufijtë teorike dhe dimensionet kryesore të strategjisë së sigurisë

Në shumëllojshmërinë e përkufizimeve, ne kemi zgjedhur se siguria është një kusht që duhet të arrihet në mënyrë që një person, grup personash, një shtet ose grup shtetesh të jetojnë dhe punojnë të lirë për promovimin e interesave të tyre, në përputhje me rregullat dhe interesat e përgjithshme, të miratuara dhe të njohura ndërkombëtarisht. Argumenti kryesor për përkufizimin e lartpërmendur është se sfera dhe fushat e manifestimit (politike, ekonomike, financiare, demografike, ushtarake, kulturore, sociale, mjedisore, informative, etj) në të gjitha nivelet e ekzistencës së individit, grupit, kombit, rajonit, në gjerësinë kontinentale dhe globale. Nisur nga këndvështrimi i përgatitjes së dokumenteve madhore të sigurisë të shumë vendeve, për të promovuar interesat kombëtare dhe për të ruajtur, promovuar një mjedis të sigurt, ka dy drejttime formulimi strategjike: e para, vendet që përpilojnë strategji për sigurinë kombëtare, dhe e dyta, në planifikimin e dokumentet të sigurisë afatmesëm dhe afatgjatë, nuk e përdorin konceptin e strategjisë së sigurisë /e sigurisë kombëtare, por cilësohen dokumente të tilla si: doktrinën e mbrojtjes, doktrinën e sigurisë, libër i Bardhë, etj, por për qëllimet janë të njëjta në të dyja

rastet. Në këtë kontekst, kemi sjellë në vëmendje faktin se projekti ynë për rishikimin e Strategjisë së re të Sigurisë merr në konsideratë faktorin e integritetit dhe bëhet vepruese nëpërmjet një sërë aktesh ligjore, nënligjore, marrëveshje dhe konventa, plane me masa për të parandaluar në mënyrë efektive kërcënimet ndaj interesave tona vitale njerëzore dhe vlerave të tjera të rëndësishme që kanë ndikim themelor në vlerat e identitetit kombëtar, të ruajtjes së sovranitetit si një vend serioz në arenën rajonale dhe ndërkombëtare. Rishikimi i dokumentit të Strategjisë së sigurisë, si një dokument i vlerësuar pas një periudhë disa vjeçare kërkon të përcjellë ndryshimet për masa të përshtatshme politike, ekonomike, diplomatike, shoqërore, juridike, arsimore, administrative, ushtarake, të zbulimit, kundërzbulimit, veprimtari efektive në menaxhimin të krizës

etj, në përputhje me rregullat e sjelljes evropiane dhe komuniteteve Euro - Atlantike. Të gjitha mënyrat e përcaktimit, vëmendja kryesore e këtij dokumenti përkthehet gjithnjë e më e dukshme në drejtimit të "sigurisë bashkëpunuese" ose "sigurisë kolektive", sidomos sot si një anëtar i NATO-s. Modeli i sigurisë kolektive përbëhet nga disa çështje të cilat konvergojnë: mbrojtja dhe hallka e parë është siguria individuale dhe hallka e dytë është siguria kolektive, mbrojtja kolektive dhe promovimi i stabilitetit. Brenda këtij koncepti qëndrojnë çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes kolektive që kanë kuptimin e duhur për organizmat e sigurisë si OKB-së, NATO-s dhe OSBE-së, të cilat sot vlerësohen për veprime aktive për sigurinë rajonale dhe globale. Ne kemi krijuar bindjen kombëtare dhe kolektive se siguria kolektive dhe siguria kombëtare janë dy koncepte të cilat janë të ndërvarura

me njëra tjetrën. Në të tashmen ku përpara kemi ndërmarrë një objektiv madhor për tu bërë pjesë e BE-së, çështjet e sigurisë bazohen në studimin e kujdesshëm të globalizimit - të sigurisë, duke treguar një balancim më konkret në drejtim të kërkesave të sigurisë ndaj veprimeve jo-ushtarake të sigurisë së qytetarëve (ekonomike, sociale, mjedisore, etj). Mendimi është se shikimi drejt së ardhshmes që duhet të udhëheqë sigurinë kombëtare, të bazohet në kapacitetin e parandalimit, përshtatjen fleksibël dhe sidomos veprim aktiv dhe përgjigjja në kohë me mjetet e duhura për të mbrojtur interesat kombëtare dhe ndërkombëtare. Një strategji sigurie mund të vlerësohet si efektive kur, pas një rreziku ose kërcënimi kapërcehet më shpejt dhe nuk pëson humbje të mëdha. Marrëdhëniet midis sigurisë kombëtare dhe vlerave kombëtare, interesat kombëtare janë logjike, në të cilën siguria kombëtare ka për qëllim mbrojtjen e tyre, pavarësisht nga rreziku, duke përdorur një instrument që lidh marrëdhënien, Strategjia për Sigurinë me integrimin e objektivave në të gjitha fushat e jetës në vend. Për sa më lart, lidhja nuk duhet të shihet në mënyrë të izoluar, por e integruar në simbiozë kolektive me strategjinë e NATO-s, BE-së, konceptet strategjike dhe në bashkëpunim me partnerët. Solidariteti dhe kohezioni brenda strukturave të përbashkëta të sigurisë duhet të shihet nga dy këndvështrime: së pari, se siguria e çdo kombi është më e fortë dhe e qëndrueshme, aleancat do të përfitojnë siguri më të madhe. Së dyti, në çdo kohë të krizës apo destabilitetit, menaxhimi bëhet nëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta. Ne pranojmë se është e rëndësishme





në vlerësimin e një dokumenti trajtimi i të gjitha aspekteve me interes për sigurinë në nivel politik, ekonomik, social, kulturor, mjedisor dhe moral. Qëllimi është të adresojmë problematikën e të çdo aspekti të "mbulimit" territorial, kombëtar, rajonal dhe kolektiv, me theks dimensionin tek problematikën kryesore që janë të ndjeshme. Në kuptimin e thjeshtë strategjia nënkupton një plan veprimi që synon arrijtjen e një qëllimi. Fjala vetë ka ngjyresa ushtarake për shkak të prejardhjes nga fjala greke. Në periudha të ndryshme kuptimi është rritur në përmasën e strategjisë kombëtare, i cili është një plan që përfshin qëllimet, objektivat dhe linjat e veprimit që duhet të arrihen në shkallë kombëtare dhe ndërkom-bëtare. Strategjia jonë e sigurisë është një faktor sintezë integruese, ajo synon bëhet vepruese nëpërmjet ligjeve, planeve, akteve, rregullave, marrëveshjeve etj, për të parandaluar dhe vepruar kundër rreziqeve dhe kërcënimeve që vendosin në rrezik interesat kombëtare, së bashku me vlerat e shtuara euro-atlantike. Ka ardhur koha të vlerësojmë perspektivën e strategjive të përbashkëta multi dhe bilaterale rajonale, ndërmyjet dy ose më shumë shtete të njëjtën zonë gjeografike, duke përfshirë planet dhe veprimet që kanë për qëllim arrijtjen e interesit të përbashkët. Shembull për çështjet integruese të strategjive është strategjia e NATO-s, e cila përfaqëson përpjekjet e përbashkëta të shteteve anëtare ose të organizatave ndërkom-bëtare për të arritur qëllimet e përbashkëta të tilla si, identifikimin e rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë dhe mënyrat për të luftuar ato. Ajo ka karakteristikën e koherencës kombëtare, rajonale, kolektive, në nivel global, në vijimësi, konsensusit dhe solidaritetit të mbrojtjes dhe sigurisë dhe në finalizimin për arrijtjen e qëllimit të sigurisë. Një strategji nuk mund të ekzistojë pa një analizë të kujdesshme të mjedisit strategjik të vendit dhe mjedisit në hapësirën rajonale ku udhëheqja politike punon dhe bashkëvepron me vendet e tjera, institucionet, organizatat dhe organet për të mirën e vendit. Mjediisi strategjik përfshin të dy kontekstet, të brendshme dhe të jashtme, me spektrin e tyre të kushteve rrethore, marrëd-

hëniet, politikat, sfidat, kërcënimet, mundësitë, bashkëveprimet që mund të ndikojnë në suksesin në lidhje me ambientin përreth. Qasja e analizës dhe pritja e zhvillimeve në mjedisin strategjik sjellin përfundime që parashikojnë nivelet e kërcënimeve dhe rreziqeve në tërësi pasi ka edhe çështje të panjohura që merren në konsideratë. Në këtë kuadër është e rëndësishme për ne që të marrin parasysh pasojat e mundshme dhe të gjitha kurset e mundshme të veprimit dhe nga ana tjetër, ndryshimet në mjedis, nuk duhet të injorohet si dhe të marrë në konsideratë kurse korrigjuese të veprimit në rast të situatave të papritura ose të pafavorshme. Historia ka treguar se mjediisi i sigurisë i nënshtrohet ndryshimeve të vazhdueshme, të karakterizuara nga luhajtje të vazhdueshme në periudhat e stabilitetit apo destabilitetit, bilanci i saj është korrigjuar gjithmonë me lidhje me natyrën e konflikteve, ku jo rrallë kanë ndodhur ndryshime dramatike në mjediset strategjike. Në kushtet e zbatimit të planit strategjik, në bazë të kriterit (strategjik, operacional dhe taktik), është e rëndësishme të theksohet se strategjia dhe planifikimi nuk është të njëjtë. Procesi i planifikimit është thelbësor në reduktimin e çështjeve të pasigurisë në nivel strategjik, operacional dhe taktik, me përshkrim të detajuar të veprimeve që duhet të ndërmerren. Në realitet, pasigurië nuk mund të eliminohej plotësisht, madje edhe në nivel taktik. Për këtë arsye, një strategji është i detyruar të provojë dështimin në qoftë se objektivat nuk janë zgjedhur me kujdes, formuluar dhe artikuluar, se çështjet specifike nuk janë përdorur si duhet për të shprehur pikërisht atë që duhet, duke pësuar në qëllimet strategjike. Në anën tjetër, konceptet strategjike si mënyrat e arrijtjes së objektiveve, shpjegojnë "si" qëllimet duhet të arrihen nga përdorimi i instrumenteve të pushtetit që sigurojnë lidhjen midis objektiveve dhe burimeve, duke shprehur "kush", "ku", "kur" dhe "pse", në mënyrë që të përmbushet një qëllim. Në mënyrë tipike, konceptet strategjike janë në qendër të interesave të strategjisë. Një strategji e përgatitur mirë është ai dokument që përmban objektivat e vendosura saktë, të shprehura

përmes koncepteve të duhura dhe të mbështetura me masat e nevojshme. Synimet e zgjedhura gabimisht për fazën e referencës së strategjisë, edhe në qoftë se konceptet e saj janë formuluar si duhet, nuk çojnë në mbrojtjen dhe promovimin e interesave kombëtare. Burimet janë mjete të vënë në dispozicion të strategjisë në mënyrë që ajo të arrijë qëllimet e saj si burimet njerëzore, financiare, materiale, pajisjet etj, të cilat lidhen me çështjet kryesore dhe kanë ndikimin e madh në nivelin e mbështetjes. Vlerësimi i nivelit të rrezikut është një proces i vështirë dhe i ndjeshëm për të parashikuar të gjitha kurset e mundshme të veprimit që mund të sjellë ambienti i jashtëm, por edhe nivelin e tyre të përshtatshmërisë ndaj ndryshimeve të papritura. Tashmë duhet theksuar se formulimi i strategjisë duhet të bëhet nga akademikë, shkencëtarë, intelektualë, profesionistë, institucione shtetërore dhe pjesëmarrja e grupeve të shoqërisë civile dhe institucione serioze ndërkom-bëtare, të cilët i kuptojnë synimet politike, nivelin e ambicies dhe mënyrën e realizimit të objektiveve, duke mbajtur në vëmendje bilancin mes qasjes diplomatike, drejtimi strategjik i dispozitave kryesore të vendit, bashkëpunimi në realizimin e objektiveve me NATO-n dhe organizmave të tjera të sigurisë, në mënyrë të vendosur në promovimin e interesave kombëtare dhe kolektive.

Roli i FA në kontekstin e kërcënimeve ndaj sigurisë

Kryesisht, roli i FA është përcaktuar nga tërësia e pritjeve të qytetarëve të vendit dhe institucionet shtetërore, detyrime këto të lidhura me plotësimin e misionit kushtetues, akteve të tjera ligjore dhe legjitime të besuara nga shoqëria jonë për sigurinë dhe mbrojtjen e vendit.

Roli i FA në kushtet e një lufte asimetrike, simetrike, rreziqeve dhe kërcënimeve të pazakonta ose hibride, përfaqëson tërësinë e pritjeve të institucioneve shtetërore me kompetenca në fushën e sigurisë që veprojnë në mënyrë adekuate, me përgjegjësi, efikasitet, fleksibilitet dhe krijimtari në përmbushjen

e misionit. Gjithashtu, roli i FA tregon mënyrën se si ky institucion në çdo kohë, pa kushte dhe mënyrë integrale realizon misionet për mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare dhe kolektive. Në ditët e sotme, FA përmbushin rolin e tyre ndaj rreziqeve të reja si luftës kundër rrjeteve terroriste dhe strukturave të kriminit të organizuar, përhapjes dhe zgjerimit të armëve të dëmtimit në masë, rreziqeve të katastrofave natyrore, njerëzore dhe teknologjike, të mjedisit, energjisë etj, duke i kushtuar kujdes përgatitjes për veprime të pazakonta dhe veprime të shpejta e vendimtare. Pas shumëzimit dhe diversifikimit e krizës dhe përforcimit të nevojave operacionale të diktuar nga interesat e sigurisë në kuadrin e NATO-s, po i kushton rëndësi krijimit të forcave të përshtatshme për t'iu përgjigjur kërkesave me më fleksibilitet, në gjendje të mbulojnë një spektër më të gjerë të misioneve (mbrojtja kolektive, të mbrojtjes së paqes, ndihma humanitare dhe qytetare, lufta kundër terrorizmit, evakuimi, ruajtja e paqes, ndërtimi i institucioneve civile dhe të stabilitetit). Gjithashtu, në planin e sigurisë një vend të rëndësishëm zë roli i FA për të ofruar mbështetje për forcat e policisë dhe shërbimeve të tjera në luftën kundër terrorizmit, kriminit, drogës dhe trafikimit njerëzor dhe ndihmë në situata të jashtëzakonshme. Në planifikimin e mbrojtjes dhe menaxhimit të emergjencave civile, FA janë pjesë e strukturave kombëtare dhe lokale me funksione të rëndësishme të mbështetjes të menaxhimit të situatave emergjente, monitorimin, rreziqet specifike të motit, përmbajtjet dhe fatkeqësitë e tjera natyrore, evakuimi i popullsisë apo asetëve të rrezikuara, ofrimi i ndihmës emergjente mjekësore, lokalizimin dhe shuarjen e zjarreve; neutralizimin e materialeve me efekte të rrezikshme, transporti i forcave dhe mjeteve të ndërhyrjes, evakuimi dhe ofrimin e strehimit për personat të dëmtuar, mbështetja dhe rivendosja e rendit publik, rehabilitimin e zonës së dëmtuar etj. Realiteti dhe përvoja e FA në operacionet humanitare për mbrojtjen civile do të vazhdojnë në planin ndërkom-bëtar sipas

angazhimeve të marra në kuadrin e NATO-s, BE-së dhe OKB-së. Kështu, operacionet mbështetëse do të vazhdojnë për të ndihmuar autoritetet civile në situatë të veçantë, duke siguruar mbështetje, shërbime, mjetet ose burimet bazë të specializuara. Tipologjia e operacioneve të mbështetjes përfshin: operacionet e mbështetjes në territorin kombëtar dhe ndihma humanitare. Kur vjen puna për operacione të mbështetjes, njësitë e Forcave të Armatosura do të zbatojnë: operacionet e shpëtimit në fatkeqësitë natyrore, mbështetjen e menaxhimit të pasojë biologjike, kimike, aksidenteve radiologjike dhe shpërthime të mëdha të energjisë, mbështetje për zbatimin e ligjit civil në ndihmë të komunitetit. Nevoja për të reduktuar kërcënimet ndaj komuniteteve pohon nevojën për të marrë disa masa të bashkërenduara dhe koherente në planin brendshëm dhe atë ndërkom-bëtar. Shqipëria, vend anëtar i NATO-s, merr pjesë me aktorët të tjerë ndërkom-bëtarë si pjesë përbërëse koalicionëve, me teknikat dhe mjetet specifike ushtarake e civile, dhe jo vetëm. Në të ardhmen vëmendja do të përqendrohet në masat më efektive si vazhdimin e politikave të harmonizimit të detyrës së FA, në kushtet e ndryshimeve në strukturat organizative dhe në karakterin e tyre si garantues i sigurisë kombëtare. Do të vijojë përqendrimi i vëmendjes që ata të marrin pjesë me të gjithë komponentët e sigurisë kombëtare, si pjesë e një sistemi ndërkom-bëtar, që përfaqëson kërkesat e disa standardeve dhe dokumenteve mbi teorinë, taktikat, teknikat dhe procedurat të nevojshme për të përmbushur misionet. Gjithashtu, roli i FA përfshin realizimin misioneve me të gjitha kategoritë e armëve dhe shërbimeve, si pjesë e planifikimit të operacioneve në nivelet nga më të ulëtat deri në ato strategjike, ku sistemet e armëve, pajisjeve, dhe materialeve të korrespondojnë me misionet e tyre për integrimin e komponentëve të ndryshme në sistemet e aleancave dhe koalicionëve që përgatisin operacionet. Në një mënyrë më të kuptueshme dhe specifike duhet që sistemet të përgjigjen për nevojën e mbikëqyrjes të një spektri shumë të gjerë të fushave ku mund të paraqiten kërcënime, të cilat duhet të sigurojnë ruajtjen e informacionit, prodhimin dhe analiza e përhershme për të parandaluar dhe luftuar format e kërcënimeve, të mbështetura këto veprime në baza ligjore dhe funksionale, për menaxhim me kriza. Sot, koha është që të rishikojmë çështjet e sigurisë si momente të rëndësishme në jetën e vendit, të cilat ndikojnë së tepërmi në aktivitetin e tyre jo vetëm të sigurisë fizike, por edhe të mirëqenies. Pra, momenti është që të shfrytëzohen të gjitha energjitë pozitive për të dhënë kontributin e nevojshëm, sado i vogël qoftë ai, por, që për mendimin e gjithkujt ai ka peshë.

Zhvillohet analiza vjetore e Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare

QNOD ballafaqohet me realizimin e detyrave të vitit 2013

Më datën 30 janar 2014 në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare u zhvillua analiza për realizimin e detyrave të vitit 2013 dhe u përcaktuan objektivat e vitit 2014. Në analizë morën pjesë koordinatorë të institucioneve pjesëmarrëse në këtë qendër, drejtues të tyre, përfaqësues nga Forca Detare, Policia Kufitare, Administrata Detare, Kapiteneria Durrës, Antikontrabandës Detare, Ministrisë së Financave, të Mjedisit, të ICITAP-it, PAMECA-s, "Guardia di Finanza", Atashetë ushtarakë të SHBA dhe Italisë, etj. Fillimisht drejtori i ri Administrativ i QNOD Maksim Malaj, i uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve, njëherësh ata i uruan suksese në detyrën e re. Më pas zoti Astrit Aliaj, zv/drejtor i QNOD, lexoi materialin e përgatitur në lidhje me zbatimin e detyrave e problematikën e vitit 2013. Ai u ndal gjerësisht në mbulimin e hapësirës detare nga sistemet që përdoren në QNOD për këtë qëllim. Por krahas arritjeve si rezultat i defekteve të ndryshme në fundvit ka pasur një rënie të monitorimit të kësaj hapësire, vuri në dukje ai. Në material u prezantuan sistemet që përdoren aktualisht në QNOD për vëzhgimin dhe monitorimin e hapësirës detare dhe u evidentua gjerësisht problematika e këtyre sistemeve të ndryshme të instaluar për monitorimin e hapësirës sonë detare, të cilat në të ardhmen duhen integruar më mirë me sistemin qendror për realizimin e detyrave të caktuara. Gjatë kontrollit dhe zbatimit të ligjit në det janë zhvilluar operacione të luftës kundër trafiqeve të ndryshme dhe atyre të lëndëve narkotike, operacione verifikimi dhe kontrolli, të kërkim-shpëtim-it, të mbrojtjes së mjedisit detar, etj. Gjatë vitit të kaluar nga institucionet pjesëmarrëse dhe bashkëvepruese të QNOD, kryesisht Policia Kufitare dhe Roja Bregdetare janë zhvilluar mbi 40 operacione të ndryshme për zbatimin e ligjshmërisë detare, shpëtimin e jetës së njerëzve dhe kapjen e trafikantëve të ndryshëm. Ndërkohë për rritjen e kapaciteteve operacionale dhe administrative të QNOD janë zhvilluar trajnime dhe stërvitje të përbashkëta për përdorimin e programeve e sistemeve në përdorim të QNOD, njohuri për komunikimin detar, kurse për SAR-in, stërvitje me Flotën e 6-të të SHBA, Passex, Complex Exercise, Preparatory Exercise, krijimi i Database për çdo ngjarje me ndihmën e përfaqësuesit të ICITAP, zotit Mark Stickevers, menaxhimi dhe arkivimi elektronik i dokumentave, realizimi i buxhetit dhe mungesat e vërejtura. Gjithashtu zoti Aliaj theksoi se nën kujdesin dhe të ish-drejtorit Shefqet Bruka, QNOD ka ndihmuar në hartimin e strategjisë së menaxhimit të integruar detar, po ashtu është përmirësuar kadri ligjor e institucional i QNOD. Vëmendje i është kushtuar komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit në QNOD



dhe projekteve për të ardhmen, ku veçojmë, sistemin IP-II, një projekt ambicioz ky që do përmirësojë rrënjësisht vëzhgimin e hapësirës sonë detare, po ashtu Road Map, për luftën kundër krimin të organizuar, kontakte me drejtuesit e projektit TAP, për detyrat e QNOD në këtë kuadër, projekti Balmas, strategjia EUSAIR, projekti i pamjes së përbashkët të Adriatikut me palën italiane, etj. Për sa i përket bashkëpunimit me partnerët u theksua bashkëpunimi me ambasadën e SHBA në Tiranë, me delegacionin e BE, "Guardia di Finanza", OSBE dhe vende të tjera të rajonit. Mbas materialit kryesor pjesëmarrësit u interesuan dhe diskutuan për probleme të ndryshme që shqetësojnë QNOD dhe përmirësimin e tyre në të ardhmen. Psh. zoti Bernt Coerner,

përfaqësues i PAMECA-IV, pyeti për gatishmërinë e sistemeve dhe kur do realizohet vënia e tyre në gatishmëri. Në lidhje me këtë personat përgjegjës theksuan se janë marrë masat dhe po bëhet tenderimi për eliminimin e defekteve të ndryshme, ku lajm i mirë, sipas shefit të Shtabit të FD, kapiten i rangut të II-të Adnand Agastra, është vendosja në punë brenda muajit shkurt e sistemit SIHVD. Zoti Mark Stickevers, përfaqësues i ICITAP në QNOD, ngriti shqetësimin për zvarritje në riparimin e Sistemit, analiza të problemeve të deritanishme dhe hartimin e planeve të dyta për monitorimin e hapësirës detare. Ndërkohë ai evidentoi domosdoshmërinë e grupeve të punës për analizimin e incidenteve detare apo problemeve që hasen në teatrin detar. Drejtori i

ri i QNOD, Maksim Malaj theksoi se këto janë probleme të rëndësishme që duhen ndjekur nga institucionet përkatëse, po ashtu dhe ngritja e grupit të analizave është një domosdoshmëri. Marinelli Fabio, përfaqësues i "Guardia di Finanza", theksoi rëndësinë e mbajtjes në gatishmëri të radarëve dhe burimeve alternative të informacionit. Përfaqësues i antikontrabandës detare theksoi rëndësinë e pajisjeve radioteknike dhe bashkëpunimin me Policinë kufitare për kontrollin e mjeteve të peshkimit para daljes dhe mbas daljes për peshkim, zbatimin e ligjeve për këtë qëllim. Kapiten i Rangut të II-të, Adnand Agastra vuri në dukje përmirësimet që do ketë këtë vit në buxhet për rritjen e kapaciteteve operacionale të FD në operacionet e pritshme detare

për vitin 2014. Roja Bregdetare do realizojë patrullime sipas nevojave të këtyre institucioneve, por dhe të bashkërenduara me këto vuri në dukje kapiteni. Kuptohet që operacionet SAR janë detyrim i Rojës Bregdetare, por bashkëpunimi me Policinë Kufitare ka qenë mbresëlënëse gjatë vitit të kaluar. Përfaqësuesi i Ministrisë së mjedisit kërkoi një skaner të problematikave të deritanishme të QNOD, me qëllim mospërsëritjen e tyre në të ardhmen, hartimin e planeve konkrete dhe eliminimin e mbivendosjes së problemeve e zgjidhjes së detyrave. Përfaqësuesi i PAMECA, përmendi ndihmën e këtij institucioni në të ardhmen, evidentimin e problemeve që mos këtë përsëritje të tyre në të ardhmen. Në mbyllje të analizës zoti Maksim Malaj vlerësoi punën e deritanishme të këtij institucioni të rëndësishëm të shtetit shqiptar për monitorimin e kufijve blu të vendit tonë dhe falenderoi institucionet partnere ndërkombëtare për ndihmën e deritanishme. Ndërkohë zoti Malaj theksoi nevojën e përmirësimeve e ndryshimeve në funksionimin e QNOD si qendër në radhë të parë dhe pastaj funksionimin e bashkëpunimit ndërinstitucional. Ai kërkoi efikasitet, disiplinë, gatishmëri dhe bashkëpunim real nga të gjithë koordinatorët e institucioneve. Me këtë rast zoti Malaj i uroi suksese personelit të QNOD për realizimin me sukses të detyrave për vitin 2014.

Shefqet Kërçelli

Testim i kadrove detarë për arsimim në Akademinë Mbretërore të Dortmund, Britani e Madhe

"Akademia Mbretërore Britanike", do të trajnojë detarët shqiptarë

Në zbatim të programit të bashkëpunimit midis Forcës Detare dhe Marinës Mbretërore të Britanisë së Madhe si dhe detyrës së Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Baze, nga data 28 deri më 30 Janar në Komandën e Forcës Detare u zhvillua testimi i kandidatëve oficerë për ndjekjen e kursit "Trajnimi fillestar i detarisë", (Initial Naval Trajning) në Akademinë Mbretërore të detarisë "Britania Royal Naval Trajning", College BRNC, Dortmund. Kandidatët kanë kryer universitetin ushtarak "Skënderbej", kursin 1-vjeçar për oficer lundrues në seksionin e detarisë, shkolla e trupës Pashaliman dhe kanë një vit eksperiencë pune në detyra të ndryshme të Forcës Detare. Komisioni testues për përzgjedhjen e kandidatëve që do kenë shansin të trajnohen në një nga shkollat më të mira të detarisë në botë përbëhet nga Shefja e Degës së personelit-arsimimit në FD, kolonele Razije Mehmeti, n/kolonel David Jones, këshilltar pranë FSK dhe kap.lt. Emrush Bedaj, specialist në Degën e Operacioneve të FD. Programi i testimit përfshinte elemente të aftësive fizike të kandidatit, aftësitë në gjuhën angleze në të shkruar, (esse), dhe njohuritë në të folur e të dëgjuar gjatë intervistës përkatëse të zhvilluar me komisionin e testimit. Tematika e intervistës krahas prezantimit kishte pyetje të veçanta për rolin e FA në shtetin demokratik, në misionet paqeruajtëse, misioni i FD, detyrat, operacionet për zbatimin e ligjshmërisë dhe ato humanitare në det, çështje të



sigurisë në rajon e botë, eksperiencat personale në detyrën funksionale, etj. Kolonele Razije Mehmeti na shpjegon se kandidatët ishin përgatitur seriozisht për këtë testim, ndaj u vu re një mobilizim e angazhim për të treguar aftësitë maksimale nga secili. Ata e kishin kuptuar se arsimimi në këtë akademi është një mundësi e mirë për tu përgatitur e formuar nga ana profesionale si ushtarak e detar. Më tepër punë duhej në përvetësimin e gjuhës angleze, e cila është element parësor për kryerjen e këtyre kurseve. Mënyra e metodat e përdorura në këtë testim janë një përvojë e mirë për ti përdorur në të ardhmen nga strukturat tona, theksoi kolonele Mehmeti. Ndërkohë më datën 30 u zhvillua një bashkëbisedim për të provuar punën në grup të kandidatëve dhe pastaj u testuan aftësitë e tyre në drejtimin e operacioneve e detyrave të nivelit taktik. Kuptohet që mbas këtij testimi do zgjidhen kandidatët më të mirë për tu trajnuar në Akademinë Mbretërore të Dortmundit Angli. Ky aktivitet u ndoq nga afër dhe nga atasheu ushtarak i Britanisë së Madhe, n/kolonel Richard Perry. Gjithashtu Atasheu ushtarak i Britanisë së Madhe, n/kolonel Perry i shoqëruar nga ushtarakë të tjerë anglezë, paraditen e datës 29.01.2014, zhvilluan një vizitë në bazën e Pashalimanit. Fillimisht ushtarakët anglezë u pritën nga komandanti i Grupit të anijeve të Flotiljes Detare, kapiten i rangut të III-të Fatmir Likskëndaj. Më pas ata vizituan ambientet e bazës së Pashalimanit dhe Qendrën Kombëtare të Zhytjeve ku u njohën me punën e këtyre efektivave për realizimin e detyrave të përditshme.

Tjetër objektiv i realizuar në operacionin e demontimit

Përfundon me sukses certifikimi i Grup-Depove të Murrashit në Elbasan

BASHKIM MALE

Përfundon me sukses përgatitja për certifikim i Grup-Depove të Murrashit në Prefekturën e Elbasanit.

Nënkolonel Maks Oranlliu, shefi operacional i Brigadës Logjistike thotë se: Certifikimi i Grup-Depove të Murrashit në Elbasan është finalizimi i një pune me përgjegjësi shumë të madhe dhe tërë hallkave që kanë marrë pjesë, që nga Ministria e Mbrojtjes deri tek ushtari profesionist që ka kryer shërbimin e ruajtjes në to. Për të arritur tek ky eveniment i rëndësishëm dhe i arritjes së këtij objekti kanë punuar për disa muaj rresht jo vetëm komanda dhe tërë trupa përbërëse e Rajonit të Elbasanit e drejtuar nga nënkolonel Edianid Elezi, por dhe Batalioni i Municioneve, i drejtuar nga nënkolonel Idris Kuca dhe Batalioni i Furnizimit i drejtuar nga nënkolonel Dod Vukaj, të cilët në bashkëpunim me njeri tjetrin sipas një plani të hartuar me detaje nga Komanda e Brigadës Logjistike, bënë të mundur pastrimin e këtyre depove dhe tuneleve. Nënkolonel Maks Oranlliu thotë për gazetën "Ushtria" se: "Këto Grup-Depo në vitin 2011 janë boshatisur dhe pastaj kanë shërbyer si magazine për municione të zbuluara në Gërdec dhe materiale të tjera xheniere. Por në vitin 2013 ishin në plan-kalendarin e zbrazjes së tyre dhe të përgatitjes për certifikim, i cili është një proces që i bën këto Grup-Deposh të kalojnë në administrim të pushtetit lokal". "Po ashtu dhe bashkëpunimi me Prefekturën dhe drejtuesit e pushtetit vendor ka qenë shumë frytdhënës dhe korrekt thotë zëvendëskomandanti i Brigadës Logjistike Besnik Sylaj".

Për pastrimin e këtyre depove dhe kontrollin të çdo centimetri të tyre për të mos mbetur asnjë grimcë municioni dhe baruti, por dhe mbetje të tjera metalike të predhave kanë punuar më shumë përgjegjësi të gjithë ushtarakët e efektivit të Rajonit të Elbasanit. Batalioni i Furnizimit ka drejtuar me kompetencë të gjithë operacionin e tërheqjes së municionit TNT nga këto depo, ndërsa Batalioni i Municioneve ka bërë një punë shumë të hollësishme për të mos ndodhur asnjë ngjarje e jashtëzakonshme dhe tërë drejtuesit e saj kanë demonstruar fleksibilitet dhe aftësi për t'ia dalë mbanë këtij operacioni të vështirë. QAME e drejtuar nga kapiten Artan Azizi dhe tërë grupet e asgjësimit, por dhe grupet e certifikimit kanë bërë të mundur që të asgjësohen me saktësi në poligonin e Voskopojës të gjitha municionet që



ishin të tepërta dhe ishin magazinuar në këto Grup-Depo. Po ashtu një punë shumë delikate dhe me rrezikshmëri të lartë në këtë rajon është bërë dhe për pastrimin dhe certifikimin e tuneleve në Murrash. Kështu për gati dy vjet rresht ky Grup-Deposh që ka shërbyer si një magazinë e madhe municionesh dhe predhash artilerie për më shumë se gjysëm shekulli tani merr certifikatën e pastërtisë dhe është plotësisht i kontaminuar. Kjo tregon dhe një herë për nivelin e lartë në të cilin kanë arritur të gjithë ushtarakët nga na profesionale dhe çdo ditë me më tepër konfirmojnë se dinë të bëjnë operacione shumë të vështira të komplikuar dhe pa asnjë ngjarje të

jashtëzakonshme. Artan Azizi thotë se: "Asgjësimi i municioneve është një sfidë e madhe që ne e kemi fituar dhe fitojmë përvojë nga dita në ditë. Në biografinë e këtij reparti janë shumë operacione të kryera me shumë përgjegjësi. Nënkolonel Maks Oranlliu thotë se: "Gjatë vitit që kaloi u certifikuan Grup-Depot në Bigas të Skraparit, Mezhgorani, Radshi dhe janë gati për certifikim Grup-Depot në Ullishtë të Elbasanit Qafë-Shtama dhe Mollëza në Burrel. Po ashtu po vazhdon puna dhe brenda muajit shkurt do të certifikohen Grup-Depot e Shmilit në Tiranë, Mbreshtani në Berat dhe Grup-Depot në Guak të Skraparit.

Ky intensitet i madh është bërë falë drejtimit me kompetencë të këtij kalendari nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, i tërë stafit të tij, drejtorive përkatëse dhe i zbatimit me përpikmëri dhe brenda afatit të detyrave nga tërë hallkat e zbatimit në terren. Ministria e Mbrojtjes Mimi Kodheli e konsideron si një nga prioritetet e rëndësishme, certifikimin dhe vazhdimin e operacioneve të demontimit në poligone dhe uzina në Direktivën e Mbrojtjes 2014. Kjo ka krijuar një situatë shumë kompetitive në Brigadën Logjistike dhe tërë mekanizmat janë vënë në punë dhe në detyrë për ta zbatuar sa

më mirë. Për direktivat nënkolonel Agim Lika, shefi i planifikimit thotë se: "Implementimi i tyre është bërë me shumë kujdes dhe po jetësohen nga dita në ditë. Kolonel Besnik Sylaj, zëvendëskomandant i Brigadës Logjistike thotë se: "Për të ardhur tek dita e certifikimit të Grup-Depove të Murrashit në Elbasan, është bërë një punë me përgjegjësi shumë të madhe nga tërë efektivit. Ka një histori të plotë të këtij rajoni dhe Grup-Depove, të cilat kanë shërbyer për mbajtjen e municioneve të Artilerisë për gati 50 vjet dhe në këto vitet e fundit janë pastruar dhe kanë marrë certifikatën e pastërtisë. E njëjta gjë po ndodh dhe me Grup-Depot e Murrashit në Elbasan. Vërtet ky është një eveniment dhe një finalizim i një pune shumë të lodhshme dhe me përgjegjësi nga tërë shtabi i Brigadës Logjistike, por dhe nga Komanda e Rajonit të Elbasanit, nga Batalioni i Municioneve dhe ai i Furnizimit, por dhe nga QAME, e cila mban përgjegjësinë direkte për këtë certifikim. Ndaj sot ne jemi krenarë për mundin dhe punën e tërë këtij efektivit, që ja ka dalë mbanë pa asnjë ngjarje të jashtëzakonshme të fitojë një betejë me municionet që kanë vite që janë nëpër depo. Ky është certifikimi i parë që bëhet për këtë vit, por do të ketë shumë shpejt dhe të tjera si ky".

Zhvillohet takimi "Këshillit Drejtues të Shkollës së Trupës", Bunavi

"Shkolla e Trupës", Prioritet, zhvillimi i kapaciteteve trajnuese

Paraditen e datës 29.01.2014 në ambientet e Shkollës së Trupës, Bunavi u mbledh Këshilli Drejtues i Shkollës së Trupës. Në këtë takim morën pjesë shefa të departamenteve e seksioneve të Shkollës së Trupës. Ky takim u udhëhoq nga komandanti i SHT kolonel Agim Shahu me atributet e kryetarit të Këshillit Drejtues. Për vitin 2013 Shkolla e Trupës ka realizuar plotësisht planin e arsimit/trajnitimit dhe njëkohësisht misionin e saj, duke mbartur kështu traditat më të mira morale, kulturore, historike, ushtarake, arsimore si baza e mësimdhënies, trajnitimit dhe stërvitjes, të ndërthurura me standardet dhe arritjet më të mira të vendeve anëtare të NATO-s. Ky takim nisi me raportimin e masave të marra për fillimin e aktivitetit të ri arsimor/stërvitor për vitin 2014. Qëllimi i këtij takimi ishte prezantimi i ndryshimeve në programet arsimore dhe stërvitore nga shefat e departamenteve e seksioneve si dhe komandanti i kurseve për programet SIB&SIA, i cili u prezantua nga shefi i Arsimit-Stërvitjes nënkolonel Albert Gjokaj. Më pas u bë njohja me problematikat e deritanishme në drejtim të masave planëzuese dhe zbatuese për fillimin e aktivitetit arsimor/stërvitor me kursantet. Mendime të shumta pati nga të gjithë Drejtuesit e Këshillit mbi ndryshimet në programet arsimore dhe stërvitore. Në këtë takim nga anëtarët e Këshillit Drejtues u diskutuan shumë çështje të rëndësishme lidhur me miratimin e ndryshimeve dhe e strukturës mësimore të programeve për kurset institucionale dhe funksionale që zhvillon kjo shkollë. Objektivi i rëndësishëm për SHT, mbetet zhvillimi i kapaciteteve trajnuese, sidomos të mësimdhënies. Ne e dimë mirë se produktivitetin në mësimdhënie e sjellin vetëm njerëzit e mirë-arsimuar, me kulturë, me ambicie dhe të motivuar, të



afte për të sjellë risi në përmbajtjen dhe metodat e drejtimit të mësimin, të aftë që të nxisin kursantët për të studiuar dhe për përgatitje individuale, pasi secili ushtarak gjen veten e tij dhe fiton besimin për të ecur përpara. Një çështje tepër e rëndësishme e diskutimit ishte mbi shpenzimet e ekonomike-financiare për vitin 2014 sipas shërbimeve, kostoja e përafërt për ushqim të garantuar, transport, harxhim karburant, shpenzime në stërvitje etj. Duke vijuar takimi, u bë njohja me direktivën e MM për vitin 2014, dhe gjithashtu me dokumentet

kryesore planëzuese të KDS-së për vitin 2014 dhe i Shkollës së Trupës, miratimi i listës së dokumenteve të planëzimit për të gjitha nivelet në të gjithë strukturat e vartësisë së SHT. Gjithashtu u trajtua dhe u diskutua plani i bashkëpunimit midis forcave në kuadrin e SOP-it. Cilësitë e kapaciteteve trajnuese rriten kur vendosen urat e bashkëpunimit me njësitë e repartet. Aftësimi i ushtarakëve të FA, rritja e performancës së tyre profesionale është produkti i përbashkët i mësimdhënies. Në këtë aspekt ky takim sollë diskutime mbi miratimin e planit të ngarkesës mësimore të personelit mësimdhënës dhe personelit tjetër jo mësimdhënës. Mbi këtë çështje u hodhën ide për një ndarje të personelit mësimdhënës dhe grupeve mësimore për kurset SIB&SIA. Aktualisht Shkolla e Trupës është duke marrë të gjitha masat për fillimin e dy kurseve të para për këtë vit, atë të stërvitjes individuale bazë dhe të avancuar që do të nisë në fillim të muajit shkurt. Kjo shkollë me asetet dhe kapacitetet unike të saj vazhdon të përmbushë me sukses po ashtu si dhe vitin e kaluar si dhe ka si prioritet të saj realizimin me sukses të arsimit/stërvitjes së ushtarakëve sipas planit arsimor të miratuar. Ky angazhim i rëndësishëm do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2014.

Togere: Rozalinda Sulovari

“EAGLE 8”

Kontributi shqiptar i kthyer në ritual, vazhdon...



Në mjediset e Batalionit të Forcave Speciale në Zall-Herr u zhvillua ceremonia e nisjes me mision në Kandahar të Afganistanit e kontingjentit “Eagle-8”. Në përcjelljen e trupave paqeruajtëse ishte e pranishme ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Viktor Berdo, atashë ushtarakë të akredituar në vendin tonë, përfaqësues të zyrës së ODC, familjarë dhe të afërm të paqeruajtësve etj. Pas fjalës së hapjes që mbajti komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, trupat paqeruajtëse dhe të pranishmit e tjerë në këtë ceremoni i përshëndeti ministrja e Mbrojtjes Kodheli. “Pjesëmarrja juaj në këtë mision, është demonstrim i angazhimit tonë kombëtar për të kontribuar në përfundimin e misionit të Aleancës në Afganistan”, theksoi, ndër të tjera, znj. Kodheli. Në vijim të fjalës së saj ministrja Kodheli shprehu vlerësime të larta për trupat tona paqeruajtëse, sidomos për kontingjentet “Eagle” që

operojnë në teatrin e operacioneve luftarake në Kanadhar, përkrah forcave amerikane, si dhe mirënjohjen e saj për kontributin që kanë dhënë dhe japin aleatët tanë dhe veçanërisht SHBA për mbështetjen e pakursyer të këtyre kontingjenteve. Ministrja Kodheli ka falënderuar edhe familjarët e paqeruajtësve për mbështetjen që u kanë dhënë atyre për përmbushjen me sukses të misionit të tyre fisnik. Kontingjenti “Eagle-8” ka në përbërje të tij 50 ushtarakë, efektivë të kompanisë së Aksioneve Speciale Ujore të batalionit të Forcave Speciale. Misioni i këtij kontingjenti është kryerja e detyrave në zonën e operacionit luftarak ISAF në Kandahar të Afganistanit. Ky kontingjent do të angazhohet në kryerjen e detyrave së bashku me forcat ushtarake amerikane që veprojnë në këtë zonë. Në përfundim të ceremonisë, ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli i dorëzoi Flamurin Kombëtar komandantit të Kontingjentit “Eagle-8”, major Agron Kuta.

Fjala e plotë e ministres së Mbrojtjes Kodheli në ceremoninë e përcjelljes së kontingjentit “Eagle - 8” me mision në Afganistan

Ministrja Kodheli: Ju jeni dhe do të mbeteni pjesa më vitale e Forcave tona të Armatosura

*Të nderuar ushtarë, nënoficerë dhe oficerë të kontingjentit “Eagle - 8”,
Të nderuar familjarë të misionarëve,
Të nderuar gjeneralë,
Të nderuar atashë ushtarakë të akredituar në vendin tonë,
Të nderuar të pranishëm në këtë ceremoni,*

Është bërë tashmë traditë që nga ky shesh të mblihdemi së bashku për të përcjellë kontingjentet tona ushtarake, si pjesë e kontributit që Forcat tona të Armatosura japin në kuadër të Aleancës, në Afganistan.

Kjo e sotmja, është një ditë e rëndësishme për të gjithë ne, veçanërisht për ju pjesëtarë të këtij kontingjenti dhe për familjet tuaja. Pjesëmarrja juaj në këtë mision, është demonstrim i angazhimit tonë kombëtar për të kontribuar në përfundimin e misionit të Aleancës në Afganistan.

Ndaj që në krye të herës dëshiroj t’ju falënderoj të gjithë ju që po niseni në këtë mision dhe përmes jush, të gjithë ata djem dhe vajza të FA që, prej më shumë se 10 vjetësh, janë rreshtuar përkrah aleatëve si të barabartë me ta, për të shërbyer atje ku paqja dhe siguria janë në rrezik. Ju jeni dhe do të mbeteni pjesa më vitale e Forcave tona të Armatosura. Ashtu si kontingjentet e mëparshme, të cilat kanë demonstruar vlerat më të larta profesionale dhe njerëzore në shërbim të paqes dhe sigurisë, shpesh duke vënë në rrezik edhe jetën, jam e bindur se edhe ju me performancën, profesionalizmin dhe sakrificën tuaj do ta lartësoni edhe më shumë emrin dhe dinjitetin e Shqipërisë dhe të Forcave tona të Armatosura.



Ju siguroj se, për kontributin që jepni, mirënjohja jo vetëm e lidershipit politik dhe ushtarak të Ministrisë së Mbrojtjes, por e gjithë shoqërisë, do t’ju shoqërojë gjithmonë. Më lejoni, të dashur misionarë të sjell në vëmendjen tuaj një shprehje, që më shumë se kujt do tjetër, juve ju përshtatet shumë. Ish-Sekretari i Përgjithshëm i OKB, në vitet 1953-1961, ka thënë “paqeruajtja nuk është një punë për ushtarët, por vetëm ushtarët mund ta bëjnë atë”. Edhe pse, si kontingjent i Forcave Speciale, ju jeni të trajnuar dhe organizuar kryesisht për të kryer operacione luftarake, ky trajnim dhe organizim ju jep një aftësi unike për të ndërmarrë disa prej funksioneve që përfshihen në çdo lloj tjetër të operacioneve të stabilitetit. Në këtë kontekst, në kushtet e një vendi i cili është duke u përpjekur për të mos u lufnjëzuar në prag të kaosit, apo duke luftuar për të kthyer paqen dhe stabilitetin, kontributi juaj së bashku me atë të vendeve të tjera të Aleancës është i paçmueshëm. Në këtë ditë të veçantë duhet të bashkohemi në

mirënjohjen e thellë për veprën e dëshmorit të atdheut kapiten Feti VOGLI i cili ra, si hero, në krye të detyrës, duke iu shtuar plejadës të mijëra dëshmorëve të cilët nuk kursyen as jetën për vendin, paqen, lirinë dhe vlerat më të larta humane, gjatë këtyre 101 vjetëve të ekzistencës së shtetit shqiptar dhe Forcave të Armatosura.

Të nderuar familjarë të ushtarakëve të kontingjenti “Eagle - 8”,

Jam e ndërgjegjshme se ju jeni garancia dhe mbështetja më e madhe që bijtë dhe vëllezërit tuaj të përmbushin me sukses misionin e ngarkuar, ndaj dëshiroj shumë sinqerisht t’ju shpreh respektin dhe mirënjohjen e thellë për mbështetjen që ju i jepni bijve dhe familjarëve tuaj dhe njëkohësisht t’ju garantoj se jo vetëm misionarët por dhe ju do të keni përkujdesjen dhe mbështetjen tonë të pakursyer.

Të nderuar pjesëmarrës,
Sot ne vlerësojmë rolin dhe kontributin e pazëvendësueshëm dhe u shprehim mirënjohjen tonë të thellë,

vendeve aleate, veçanërisht qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për mbështetjen e pakursyer që u kanë dhënë dhe vazhdojnë t’u japin këtyre kontingjenteve, jo vetëm në fushën e trajnimit me stërvitjet para dislokues, por gjithashtu, për besimin, vlerësimin dhe bashkëpunimin që ofrojnë edhe në teatrin e operacioneve në Afganistan. Ne ndihemi krenarë të jemi përkrah Shteteve të Bashkuara të Amerikës në operacionet paqeruajtëse dhe do të vazhdojmë kështu edhe në të ardhmen, për të përfunduar kështu një operacion që e kemi nisur së bashku. Prania e FA të Shqipërisë në këto misione, ka shërbyer, përveç të tjerash edhe si një indikator i rëndësishëm i testimit të kapaciteteve të njësive tona për të kryer misione në një mjedis të komplikuar sigurie, në përbërje të një forcë shumëkombëshe. Në këtë kontekst, nuk ka se si të mos ndihemi mirë kur dëgjojmë vlerësimin e lartë që aleatët tanë shprehin për performancën e forcave tona. Kjo, padyshim,

na e shton edhe më shumë ndjenjën e përgjegjësisë dhe detyrimin të vazhdojmë të jemi në të tilla standarde edhe në të ardhmen. Këtë do të kërkoja edhe nga ju, të dashur efektivë të këtij kontingjenti.

Të nderuar ushtarakë që niseni në këtë mision,

Këto 23 vitet e fundit Forcat e Armatosura janë angazhuar në një sërë detyrash për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në rajon dhe me gjerë, ndaj dhe sot jemi krenarë për traditën e krijuar dhe përvojën e përfituar. Si ministër i Mbrojtjes dëshiroj t’ju siguroj se qeveria është e vendosur t’ju mbështesë në rrugën e përmirësimit të vazhdueshëm të kapaciteteve njerëzore dhe teknike, modernizimin e pajisjeve, si dhe për krijimin e kushteve më të mira infrastrukturore duke vendosur në ekuilibër resurset në dispozicion me nevojat gjithnjë në rritje. Ende mbetet shumë për t’u bërë, por është me rëndësi të theksojmë se ju keni atë çka nevojitet për të përmbushur misionin e ngarkuar. Ju keni kapacitete të plota operacionale, jeni të stërvitur njësoj si në kushtet e luftës dhe çka është më e rëndësishmja ju keni vullnetin për t’i dalë ballë detyrave tuaja. Jam e bindur që edhe ju do të vazhdoni me vendosmëri në rrugën pa kthim, për të përfaqësuar denjësisht Forcat e Armatosura dhe vendin tonë si një vlerë e shtuar në Aleancë. Ju përshëndes të gjithëve, ju dhe familjarët tuaj! Dalshi faqebardhë dhe u kthefshi shëndoshë e mirë! Së fundi, dëshiroj, tashmë jo si ministre, të përshëndes fëmijët tuaj dhe t’ju them se, këto 6 muaj do të kalojnë shumë shpejt, dhe sapo të keni mbaruar vitin shkollor, baballarët tuaj do të jenë pranë jush. Të jeni krenarë për etërit tuaj.

“Eagle 8”, nuk është rutina e zakonshme...



Për shumë shqiptarë, nëse do të shihnin kronikën e nisjes së një kontingjenti paqeruajtësish për në një mision, qoftë ky i fundit edhe një mision i rrezikshëm apo një mision i ri, në të cilin FA shqiptare nuk ka marrë pjesë ndonjëherë – nuk përbën lajm! Nuk përbën më lajm, pasi të zhytur në rutinën e në hallet e përditshme që i rrethojnë, shumëkush mendon se këto misione janë një rutinë, një detyrim ushtarak, një pjesëmarrje në një nismë më të gjerë se Shqipëria ose thjesht një punë, një punë e profesionit ushtarak. Ky mendim në lidhje me rutinën, është thyer të paktën një herë. Them të paktën një herë, pasi ne kemi veç një Dëshmor të rënë në këto misione, kapiten Feti Voglin. Ka pasur edhe raste plagosjesh apo raste rreziqesh, po në një rast të vetëm, “tërmeti” tregoi se ai nuk është vetëm dridhje, por është dhe shembje.

Në këtë mënyrë, tronditja me këtë përballje, me rënien në krye të detyrës së një ushtaraku shqiptar, atje larg në Afganistanin që e njohim veç prej lajmeve, qenkëshe realitet. Rutina e atyre kronikave të kontingjenteve që niseshin drejt rërës së përgjakur të Afganistanit, doli përsëri në pah dhe nuk mbeti person pa u ndërgjegjësuar se këta ushtarakë shqiptarë që dërguakemi atje, paskan edhe rreziqe jete. Efekti i kësaj ngjarje zgjati aq sa dihet dhe në këtë mënyrë, përsëri nisja e në mision e kontingjenteve u kthye në një rutinë, në një lajm që nuk përben lajm për mediet.

Por këto kronika që regjistrohen e që shfaqen aty këtu si në formë fotosh edhe në formë videosh, lënë pas gjurmë të cilat veç koha e di nëse do të jenë gjurmë të dukshme apo jo. Dhe rastësia nuk vepron sipas rregullave tona njerëzore. Në dokumentarin e realizuar nga QKMBM, për Dëshmorin Feti Vogli, shfaqen disa pamje të Fetiut të filmuara qysh kohë më parë se ai të ishte nisur për mision. “Kemi pasur plane të tij krejt rastësore, të mëparshme, të filmuara në kohë, të cilat i kemi gjetur më pas. E çuditshme se si vijnë punët...” – do të më thoshte kolegu e miku im Agron Goga, shefi i Sektorit të Multimedias në QKMBM, teksa shikonim jo të pa emocionuar këtë dokumentar të realizuar mjeshtërisht.

E përmenda këtë gjë pasi mes pjesëmarrësve në misionin e “Eagle 8” ndodhet edhe një person i cili përballlet me një sfidë të cilën do e kishin të vështirë shumë individë. Ai është tetar Aleksandër Peci. Aleksandri është pjesë e kontingjentit të misionit “Eagle 8” dhe në këtë mënyrë ai po rikthehet edhe një herë atje ku jeta e tij “u var në një fije peri”. Normalisht që një përballje e tillë, pasi ke kaluar eksperiencën e mëparshme nuk është e lehtë. Nuk është e lehtë për atë vetë, e as për familjen e tij. Nuk është e lehtë as për shokët që e shoqërojnë, një pjesë e të cilëve ka qenë me të edhe në misionin “Eagle 5”. Ajo sfidë me të cilën përballlet Aleksandri është sa vështirësi aq edhe premtim: premtim për ecjen para, në rrugën ku Feti shkeli, në atë rrugë në të cilën shkelin të gjithë pjesëtarët e kontingjenteve shqiptarë që marrin pjesë në misione luftarake, rruga e plotësimit të betimit ushtarak. Teksa sheh fotografinë e Aleksandërit që nisët në mision, mund të shkruash mendime të ndryshme ashtu siç edhe mund të rrih në heshtje përpara këtij akti, sa të thjeshtë në dukje, aq edhe fisnik. Misioni “Eagle 8” mund të jetë misioni radhës për shumë persona që e shohin në TV apo gazeta, por pa dyshim që nuk është rutinë për ata që do e kryejnë e pa dyshim që nuk është rutinë për Aleksandër Pecin, i cili po krahas guximit po e vesh figurën e tij e të ushtarakut shqiptar edhe me një veshje tjetër, që quhet Moral. Ky Moral e ky Guxim është ai që e bën profesion e ushtarakut të lartësuar ndër të tjerë dhe për këtë arsye duhet mirëmbajtur me të vetmin “kopshtar” që di të kujdeset për të: Ndershmëria profesionale.

Mision të mbarë e u kthefshi me nder!

Albert Hitoaliaj





50 trupa të kontingjentit "Eagle 8", efektiv të Batalionit Special, nisen për mision në Kandahar, Afganistan

"Eagle 8", shqiptarja shqiptare drejt shkretëtirës afgane...

Me datë 24 janar 2014, ora 9.30, në sheshin "Komando", u zhvillua ceremonia e përcjelljes për misionin e radhës në Kandahar, Afganistan të kontingjentit "Eagle 8", efektiv i Kompanisë të Aksioneve Direkte të Batalionit Special, strukturë vartëse e Forcave Tokësore. Në ceremoni mori pjesë ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Viktor Berdo, atashe ushtarakë të akredituar në vendin tonë, përfaqësues të zyrës së ODC, drejtor Drejtorish në SHPFA, familjarë dhe të afërm të paqeruajtësve etj. Ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli e shoqëruar nga zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Viktor Berdo dhe komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, kalon në revistë nderi trupat. Fjalën e rastit e mbajti komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, i cili nën cilësinë e mikpritësit i falënderoi të pranishmit dhe ju uroi mirëseardhjen në ceremoni. Prezencën e tyre e konsideroi një vlerësim dhe respekt për punën, djersën dhe sakrificat e këtyre djemve, që nisen në një mision mjaft të rëndësishëm. Misioni "Eagle", vijoi gjeneral Dushku, është i vështirë dhe përfshin detyra me rrezikshmëri, por falë eksperiencës, trajnimit dhe profesionalizmit të lartë të këtyre ushtarakëve, jam besimplotë se ky mision do të vijojë të jetë një histori suksesi. Ai shprehu mirënjohje për ndihmën e vazhdueshme dhe mbështetjen e pakursyer të SHBA në mbarëvajtjen e këtij misioni, e në mënyrë të veçantë për besimin që na kanë dhënë për të operuar së bashku. Gjeneral Dushku në emrin e efektiveve të FT, siguroi ministren e Mbrojtjes, Kodheli se ashtu si deri më sot, ne do të vazhdojmë së bashku përpjekjet tona për rritjen dhe konsolidimin e aftësive luftarake, të nivelit të stërvitjes dhe operacionalitetit,

për të qenë gjithmonë të gatshëm për realizimin më së miri të misionit dhe detyrave të ngarkuara. Në fjalën përshëndetëse, ministrja e Mbrojtjes Kodheli theksoi se: "Pjesëmarrja juaj në këtë mision, është demonstrim i angazhimit tonë kombëtar për të kontribuar në përfundimin e misionit të Aleancës në Afganistan".

Në vijim të fjalës së saj ministrja Kodheli shprehu vlerësime të larta për trupat tona paqeruajtëse, sidomos për kontingjentet "Eagle" që operojnë në teatrin e operacioneve luftarake në Kanadhar, përkrah forcave amerikane, si dhe mirënjohjen e saj për kontributin që kanë dhënë dhe japin aleatët

tanë dhe veçanërisht SHBA për mbështetjen e pakursyer të këtyre kontingjenteve. Ministrja Kodheli ka falënderuar edhe familjarët e paqeruajtësve për mbështetjen që u kanë dhënë atyre për përmbushjen me sukses të misionit të tyre fisnik. Në përfundim të ceremonisë, ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli pasi i

dorëzoi Flamurin Kombëtar komandantit të Kontingjentit "Eagle-8", major Agron Kuta, mori takim me familjarët e misionarëve. Ajo i falënderoi ata për mbështetjen e vazhdueshme për njerëzit e tyre të dashur dhe i siguroi se qeveria shqiptare, MM e SHPFA do jenë në çdo kohë pranë tyre.

Kontingjenti "Eagle 8", i mirë-trajnuar dhe besimplotë në përmbushje të misionit

Batalioni i Forcave Speciale është njësi speciale e Forcave të Armatosura Shqiptare, strukturë vartëse e Forcave Tokësore. Nga viti në vit ky batalion, ka rritje në performancën e tij. Ai ka për mision kryerjen e operacioneve speciale për plotësimin e objektivave kombëtare dhe në kuadër të Aleancës. Që nga krijimi më 16 Tetor 1998 e deri më sot ka marrë pjesë në disa operacione dhe shërbime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Një ndër operacionet e para ka qenë ai i konfliktit të Kosovës në vitin 1999, ku për 6 muaj rresht grupet speciale të këtij batalioni kanë marrë pjesë aktive në monitorimin e kufirit, menaxhimin e krizave të ndryshme e detyra të tjera të natyrave speciale. Po ashtu ky batalion ka një kontribut të dukshëm në misionet paqeruajtëse dhe luftarake jashtë vendit, sidomos në përbërje të kontingjenteve në Bosnje-Hercegovinë, në Irak, Çad (Afrikë), Kabul, Afganistan, si dhe nga Korriku i vitit 2010 e deri në ditët e sotme, kur përcillet kontingjenti i radhës "Eagle 8", në Kanadhar, Afganistan. Krahas këtyre angazhimeve ka marrë pjesë edhe në operacione kërkim shpëtimi në det, në lumin Osum, në mal për gjetjen e turistëve, në përmbajtje në Shkodër, në lumin e Tiranës, në shuarje zjarri, në disa stërvitje të përbashkëta me palën amerikane, britanike etj. Dita e premte e 24 janarit, natyrisht nuk ishte si gjithë ditët e zakonshme, pasi në këtë ditë ju dha bekimi nga ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli, komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, familjarët dhe gjithë të pranishmit, kontingjentit "Eagle



8", "për përmbushje me sukses të misionit fisnik dhe kthim shëndoshë e mirë në Atdhe". Janë gjithsej 50 paqeruajtës shqiptarë, nga të cilët 12 oficerë dhe 38 nënoficerë, efektiv të Kompanisë të Aksioneve Speciale Ujore, të këtij batalioni, që do operojnë përkrah trupave të Aleancës dhe veçanërisht atyre amerikane, në misionin e radhës në bazën Spin Boldak në Kandahar, Afganistan. Në trajnimin e kontingjentit para nisjes në mision zë vend stërvitja paradislokuese me efektivat e kontingjenteve "Eagle", si një nga stërvitjet kryesore dhe mjaft të nevojshme për rritjen e operacionalitetit dhe profesionalizmit të personelit, stërvitje këto të realizuara më së miri nga instruktorët shqiptarë në bashkëpunim me ato amerikanë. Angazhimi i Forcave Speciale në misionet përkrah trupave të aleancës, arritja e standardeve dhe përgatitja e lartë tekniko-profesionale e demonstruar në

kontingjentet "Eagle 1-7", me partnerët e NATO-s, modernizimi i pajisjeve, teknikës dhe armatimit, që Forcat Speciale disponojnë, tregon qartë nivelin gjithmonë në rritje, përkushtimin dhe motivimin e efektivit të Batalionit të Forcave Speciale. Komandanti i kontingjentit major Agron Kuta, me një eksperiencë në misionet ndërkombëtare, i pyetur për gazetën "Ushtria", shprehet se kontingjenti "Eagle 8", shkon në këtë mision i trajnuar në përgatitje taktike, teknike, përgatitje fizike, shëndetësore, psikologjike etj, si dhe me një përvojë të gjatë bashkëpunuese me trupat amerikane, përvojë e cila ka ardhur në konsolidim dhe që është transmetuar nga njëri kontingjent në tjetrin. Kjo, shprehet major Kuta, na jep besim në vetvete për të realizuar me sukses të gjitha detyrat dhe obligimet tona në bashkëpunim me trupat amerikane, forcat dhe popullsinë afgane me të cilët kemi krijuar lidhje besimi të ndërsjella. Kontingjenti që unë drejtoj do të operojë në zonën Spin Boldak, Kandahar, Afganistan, duke dhënë kontributin tonë në menaxhimin e kufirit në zonën me Pakistanin, të doganave, trajnimin e forcave afgane, me qëllim, plotësimin e objektivit primar të këtij misioni që së bashku me Komandën Amerikane të bëjmë kalimin gradual të sigurisë në duart e forcave afgane të sigurisë. Jemi të sigurt dhe të vetëdijshëm, se do ta kryejmë me sukses këtë mision, duke nderuar veten, kombin, flamurin shqiptar, Forcat e Armatosura dhe familjet tona të shtrenjta.

Major Nexhbedin Basha

Flet Zv/Komandanti i Forcave Tokësore, Kolonel Dilaver Hoxha

65 ushtarakë të Forcave Tokësore,
fillojnë kursin e gjuhës Angleze

Kolonel Dilaver Hoxha, zv/komandanti i FT: "Gjuha e huaj përbën një nga shtyllat kryesore për të matur rezultatin për kualifikim të mëtejshëm, promovim në gradë dhe karrierë..."

Nënkolonel Shpëtim Hysa
Major Nexhbedin Basha

Me datë 20 janar 2014, në ambientet e Qendrës së Gjuhëve të Huaja në Forcat Tokësore, në Batalionin e parë të Këmbësorisë, Vau Dejës, Batalionin e Dytë, Zall Herr dhe Batalionin e Tretë, Poshnje, filloi kursi i mësimin të gjuhës angleze në nivelin e parë dhe të dytë. Në Qendrën e Gjuhëve të Huaja të kësaj force në ceremoninë e hapjes së kursit mori pjesë zv/komandanti i FT-së, kolonel Dilaver Hoxha, i shoqëruar nga shefi i Degës së Personelit në FT, nënkolonel Bardhyl Nuredinaj. Gjithsej në nivelin e parë ky kurs po ndiqet nga 33 vetë dhe niveli i dytë 32 vetë, gjithsej 65 veta. Në fjalën e tij zv/komandanti i FT-së, kolonel Dilaver Hoxha, gjatë hapjes së kursit, përcolli mesazhin e komandantit të Forcave Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, ku theksin e vuri tek rëndësia që paraqet mësimi i gjuhës së huaj, përfshi perfeksionimin e gjuhës operacionale të NATO-s, kryesisht për ushtarët profesionistë dhe nënofficerët. Në këtë kontekst kërkohet intensitet i lartë dhe impenjim i vazhdueshëm si nga kursantët edhe nga instruktorët përkatës, përkushtim dhe gërshetim i punës në grup me punën individuale, disiplinë dhe monitorim rezultatesh. Vetëm kështu mund të sigurojmë selektimin objektiv të aftësive për gjithsecilin. "Viti 2014, u shpreh koloneli, është viti i parë që i gjen Forcat e Armatosura plotësisht të integruara në NATO, pjesë kryesore përbërëse e të cilave janë Forcat Tokësore. Ndër treguesit bazë që reflekton këtë realitet është përdorimi i së njëjtës gjuhë komunikimi. Kuptohet, theksoi ai, që ky nuk është i vetmi tregues,



pasi janë një numër i konsiderueshëm detyrimesh që sigurojnë integrimin e plotë në Aleancë. Gjuha angleze, përbën elementin bazë fillestar të një fushe, konkretisht asaj të trajnimit. Për më tepër, siç edhe dihet, integrimi përfshin tetë fusha kryesore dhe secila prej tyre ka elementët e saj. Më konkretisht, këto fusha ku synohet sigurimi dhe mbajtja e një ndërveprimi të plotë përfshijnë: Doktrinën (D); Organizimin (O); Trajnimin; Lidhshmërinë (L); Mirëmbajtjen (M); Personelin (P); Fasilitetet-pajisjet (F) dhe infrastrukturën (I)". Më pas, zv/komandanti, u ndal tek rëndësia që ka mësimi i gjuhës angleze, kjo e parë në këndvështrimin specifik, si gjuha e NATO-s. Në rastin konkret gjuha angleze, përbën një detyrim të pa diskutueshëm, që secili duhet të zotërojë aftësitë e duhura sipas gradave dhe vendit të punës. Në të njëjtën kohë, theksoi më poshtë në fjalën e tij, se është detyrim që krahas gjuhës së folur, të sigurohet dhe perfeksionohen njohuritë në gjuhën operacionale për secilin specialitet. Kjo nuk do të

thotë, ju drejtua ai kursantëve, që të lihet në harresë, gjuha e dytë zyrtare e NATO-s, ajo franceze, po kështu edhe gjuhët e tjera të vendeve të Aleancës, si: gjermanisht, italisht, turqisht, greqisht, spanjisht, etj. Njëkohësisht e konsideroi luks dhe një mundësi më tepër për çdo ushtarak praninë brenda garnizoneve ushtarake të Qendrës së Gjuhëve të Huaja në shkallë Force të Armatosur ashtu edhe në nivel Force Tokësore e batalioni, ku secili duhet ta shfrytëzojë në maksimumin e mundësinë që u jepet. Vetëm në nivel force, u shpreh ai, kemi kapacitete për të studiuar rreth 300 ushtarakë në vit ndarë në tre sezone. Natyrshëm që në mënyrë graduale, do të kalohet nga nivelet fillestare në nivele të avancuara, e më pas për t'u fokusuar tek gjuha operacionale. Ndaj brezi i ri ushtarak, që po ndjekin kurset e gjuhës së huaj në Forcën Tokësore dhe repartet e saj të vartësisë, i ka të gjitha mundësitë që gjuhën ta përfitojë njëkohësisht me arsimimin që kryen në një fushë të caktuar. Në kohën që jetojmë sot, ky është një obligim individual që

nuk duhet të bëhet barrë për Forcat e Armatosura. Megjithatë kjo mundësi e krijuar, nuk duhet neglizhuar, por të shfrytëzohet maksimalisht nga të dy palët, si kursantët ashtu dhe trupa pedagogjike, duke zbatuar me rigorozitet rregullat e përcaktuara në ndjekjen e këtyre kurseve, që detyrimisht janë të zbatueshëm për secilin person. Ai ve në dukje se kursantëve u kemi krijuar kushte optimal jo vetëm për të studiuar, por edhe për zhvillimin e punës së pavarur. Njëkohësisht nuk duhet të harrojmë edhe kriteret e vendosura për matjen e rezultateve si dhe penalitetet për mos arritjen e këtyre rezultateve. Në mënyrë të veçantë e vuri theksin se gjuha e huaj përbën një nga shtyllat kryesore për të matur rezultatin për kualifikim të mëtejshëm, promovim në gradë dhe karrierë. Gjuha angleze edhe në të ardhmen, mbetet një ndër prioritetet më të rëndësishëm për vlerësimin e kuadrit ushtarak të gjitha niveleve. Kjo vlen jo vetëm për oficerët, nënofficerët, por edhe ushtarët profesionist. Personeli i Qendrës së Gjuhës të Huaj të KFT ka zhvilluar në mënyrë periodike kurse për ushtarakët e Komandës të Forcave Tokësore, kurse këto të zhvilluar me sukses dhe me një nivel përvetësimi të kënaqshëm të temave dhe ushtrimeve të gjuhës angleze. Kapacitetet e kësaj qendre, gjithashtu edhe pajisjet të cilat janë në dispozicion të saj kanë rritur efektivitetin e mësimdhënies. Gjatë vitit 2013 ndoqën kursin 111 veta në nivelin e parë dhe të dytë dhe 12 veta me kohëzgjatje 5 javor kursin e Terminologjisë Ushtarake. Në prononcimin e tij për gazetën "Ushtria", nënkolonel Bardhyl Nuredinaj, shprehet se Qendra e Gjuhëve të Huaja në FT është e kompletuar me Instruktorët të gjuhës angleze me mjaft eksperiencë si dhe me të gjitha pajisjet e kapacitetet, të cilat ndihmojnë më së miri në procesin e mësimdhën-

nies. Po kështu edhe laboratorët e gjuhës angleze në repartet e Forcave Tokësore janë të pajisur me të gjithë bazën materiale të nevojshme. Në këto laboratorë janë angazhuar në rolin e instruktorit personeli i cili ka ndjekur kursin bazë të instruktorit të gjuhës angleze në SHBA. Me qëllim që të rritet më tej niveli i mësimdhënies në të gjitha këto laboratorë dhe shfrytëzimin me kapacitet maksimal të tyre kemi pasur bashkëpunim të vazhdueshëm me Sektorin e Arsimit në MM dhe me Zyrën e Bashkëpunimit Amerikan (ODC) për të mundësuar dërgimin e personelit të FT në SHBA, në kursin e instruktorit të gjuhës angleze. Këtu shfrytëzoj rastin të falenderoi Zyrën e ODC-së për personelin e dërguar për kualifikim në SHBA, si dhe për gjithë bazën materiale të dhuruar nga Qeveria amerikane të vënë në dispozicion të Qendrës së Gjuhëve të Huaja dhe të Laboratorëve të gjuhës angleze të FT. Në anën tjetër do të theksoja se shihet një interesim edhe më i madh nga personeli i FT-së për rritjen e nivelit të gjuhës angleze. Objektivi ynë, për vitin 2014, është shfrytëzimi me kapacitet maksimal i QGJH dhe i laboratorëve, me qëllim rritjen sasiore dhe cilësore të nivelit të gjuhës angleze të personelit, duke përfaqësuar FARSH në të gjitha aktivitetet dhe operacionet e kërkuara në kuadrin e Aleancës e më tej. Për vitin 2014 do të vazhdojmë të shfrytëzojmë me kapacitet të plotë QGJH në FT dhe laboratorëve me objektivin si më poshtë: 100 personel për ndjekjen e kursit të gjuhës angleze në nivelin e dytë, QGJH, 240 personel nivelin e parë në reparte dhe 70 personel nivelin e parë në reparte të terminologjisë ushtarake në QGJH. Aktualisht kryejnë nivelin e parë të gjuhës angleze 33 vetë në reparte dhe 32 vetë në nivelin e dytë në Qendrën e Gjuhëve të Huaja, në FT.

Atashetë Ushtarake të akredituar në Shqipëri, vizitë në Policinë Ushtarake



Me datë 29 janar 2014, Atashetë Ushtarak të huaj të akredituar në vendin tonë zhvilluan një vizitë njohëse në Policinë Ushtarake, ku u pritën nga komandanti i Policisë Ushtarake kolonel Xhevdet Zeneli. Në këtë takim me anë të një brifingu të shkurtër, ushtarakët e lartë u njohën me misionin, detyrat, strukturën dhe objektivat e PU-së për të ardhmen. Në fjalën e tij, komandanti i PU-së pasi shprehu mirëseardhjen e Atasheve Ushtarakë në Policinë Ushtarake falenderoi vendet me të cilët Policia Ushtarake ka patur bashkëpunime gjatë këtyre viteve, si me Gardën e New Jersey, Komandën e Xhandarmërisë Turke, Karabinierinë Italiane etj. Bashkëpunimi me këto shtete ka qenë në drejtime të kualifikimit të personelit, zhvillimeve të kurseve stërvitore si dhe mbështetje logjistike. Oficerët e kualifikuar në Itali, SHBA dhe Turqi, me prezencën e tyre kanë bërë të mundur që të ngrihet performanca dhe kualiteti i përfaqësimit të Policisë Ushtarake. Për kualifikimin e personelit të PU-së janë zhvilluar trajnime dhe kurse për instruktorët dhe efektivat tanë nga instruktorët Italian

dhe Turq, në drejtimet e Teknikës së Hetimeve Shkencore, Teknikës së Marrjes në Pyetje si dhe tema të profilit taktik duke filluar nga Teknikat e Përdorimit të Armëve Vdekjeprurëse deri te Teknikat e Qitjes Operative. Gjithashtu prej tre vitesh një togë e Policë Ushtarake kryen stërvitje të përbashkëta me trupat Amerikane në JRCM HOHENFELS në Gjermani. Për të ardhmen, kolonel Zeneli u shpreh se objektivat e PU-së janë vendosja dhe mbajtja e standardeve të larta si të partnerëve tanë në NATO. Në përfundim të takimit Atasheu Ushtarak i Republikës Italiane gjeneralbrigade Vito Dell'Edera e uroi kolonel Xhevdet Zenelin për punën dhe rezultatet e shkëlqyera të arritura nga Policia Ushtarake, si dhe shprehu mbështetjen e Atasheve Ushtarakë për Policinë Ushtarake dhe vazhdimësinë e bashkëpunimit të ndërsjellë. Gjeneralbrigade Vito Dell'Edera përfundoi fjalën e tij me një falenderim të veçantë për Policinë Ushtarake dhe komandantin e saj kolonel Xhevdet Zenelin për mikpritjen e ngrohtë dhe miqësore.

Nëntogere Xhesika Xhajku

Një këndvështrim për Ismail Qemalin

KDS, zhvillohet nga QLMI veprimtari përkujtimore për Ismail Qemalin

Nga: PANO HALLKO

QLMI-ja organizoi një veprimtarinë “Ismail Qemali – Kryeministri i Parë i shtetit shqiptar”, në kuadrin e 170 vjetorit të lindjes (16 janar 1864) dhe 95 vjetorit të vdekjes (24 janar 1919). Qëllimi ishte të njihet jeta, puna dhe veprimtaria e bërë nga Ismail Qemali për shtetin shqiptar dhe FA nëpërmjet studimit të librave të botuara për të në këto 101 vjet të shtetit shqiptar. Në veprimtari morën pjesë drejtues të institucioneve, pedagogë të AFA-së, punonjës të bibliotekave në KDS-së, etj. Në fjalën e hapjes së veprimtarisë drejtori i QLMI-së Bernard Zotaj, foli për kontributin e madh të dhënë nga Ismail Qemali në shtet-formimin e Shqipërisë. Shefi i sektorit të librit, Pano Hallko foli për një këndvështrim mbi figurën e Ismail Qemalit. Më tej u vazhdua për roli diplomatik i I. Qemalit në shpalljen e shtetit shqiptar, mbajtur nga Elisabeta Koka, shefe e sektorit të bibliotekave, ndërsa Florentina Shiroka, Specialiste e sektorit të mbështetjes me informacion diskutoi në lidhje me botime dhe shkrime rreth figurës së I. Qemalit nga autorë shqiptar dhe të huaj. Adriana Zotaj, specialiste e sektorit të planifikimit të librit, diskutoi për figurën e I. Qemalit si burrë shteti, qeveria dhe ministrat e saj dhe Dukate Dedndreaj, specialiste e sektorit të mbështetjes dhe informacionit, sollti disa fakte nga jeta e I. Qemalit. Më poshtë jepet i plotë prezantimi kryesor për këtë

Përtej atyre që njohim të gjithë për Ismail Qemalin, e sidomos për rolin e tij vendimtar në shpalljen e Pavarësisë dhe themelimin e shtetit shqiptar, përtej atyre që opinioni i gjerë njih me shumë përmes filmit “Nëntori i Dytë”, mendoj se është me interes të dimë disa gjëra sa i takon lindjes, rritjes dhe ngjizjes së tij si atdhetar, por edhe si një nëpunës i lartë i Perandorisë, një punë 40 vjeçare në drejtimin e një sërë shtetesh të ndryshme, në të gjithë botën e Lindjes. Duhet kjo, pasi asgjë nuk është rastësi, e për pasojë nuk mund të ishte rastësi vepra e tij madhore në shërbim të kombit. Ai u lind më 16 Janar 1864 në Vlorë, një vit para botimit të dytë të Abetares së Naum Veqilharxhit me titull: “Fare i Ri Evetor Shqip”. Kur ishte ende i vogël, familja e tij u internua tre vjet në qytetin e Selanikut. Kjo periudhë luajti rol për ngjizjen e një cilësie në personalitetin e tij, që do ta shoqëronte gjatë gjithë jetës së tij. -Dashuria për të gjithë popujt dhe kombet. Marrëdhëniet e para familja i ndërtoi me patriotë elbasanas që ishin aty të internuar, por edhe me pasuri të patundura. Jo më pak pati marrëdhënie familja edhe me izraelitët, të cilët ndodheshin aty qysh nga fillimi i shekullit të XV-të, e që ishin shumicë në atë qytet, me turqit që vinin të tretët nga numri i popullsisë, me bullgarët-që ishin të dytët. Po aty, në atë qytet, atij i vdiq vëllai i vogël. Ndaj ai vite më vonë do të shkruante: “Deri më sot, sa herë që ndodhem në Selanik, e konsideroj detyrë të vizitoj varrin e tij të vogël prej mermeri në oborrin e xhamisë “Ortai”. Kjo xhami, ashtu si



qindra të tjera në Greqi, u shemb para një shekulli. Po në këtë qytet kozmopolit, ai kreu shkollën fillore, në gjuhën turke. Por ...“Babai im -do të shkruante ai në Kujtimet e veta, -qysh në fillim u kujdes që të më jepte shijen e kulturës europiane”. Pas pak vitesh, familja u kthye në Vlorë, pasi babai i tij u emërua qeveritar i saj. Në kujtesën e tij mbeti edhe fakti që, të gjithë ata qytetarë të Vlorës që u kishin blerë sendet dhe mobiljet kur ikën në internim, tani ua dhuruan ato, pa kërkuar të holla. Në Vlorë ai u fut gjuhës italiane, që asokohe ishte thuarje e vetmja gjuhë perëndimore. “Përveç studimeve, unë mora një edukatë tipike shqiptare, doemos nën drejtimin e babait tim, por sidomos të kujdesit të nënës sime gjirokastrite, e cila më donte që unë të bëhesha një shqiptar i përsosur”. Në shkollën “Zosimea” të Janinës, ai do të mësonte edhe frëngjishten, gjuhën e Volterit dhe të Revolucionit. Pas përfundimit të shkollës në Janinë, ai do

të shkonte në Stamboll. Djaloshi i ri, nuk mundi t`i shpëtonte gjykimin të një diplomati francez, i cili do t`i thoshte një ditë gazetarit francez Stefan Lozan: “Shikoje mirë këtë njeri. Ai një ditë do të jetë kryeministër, a ndoshta kryetar i një shteti që sot nuk ekziston”...(aqsh, fondi 20, dosja 17). Vazhdoi punën në zyrën e përkthimeve për llogari të qeverisë. Aty i vdes i ati, i ri, në moshën 44 vjeçare, ... “Një goditje shumë e pikëlluar për mua dhe gjithë familjen”, shkruan ai.. Për vite të tëra ai punoi si adjutant, e më pas si shef zyre e këshilltar i një burri të madh shtetbërës, siç ishte Mit`hat Pasha. Së bashku, ata ndanë mendimin në qeverisjen e shumë vilajeteve dhe shteteve. Në Vilajetin e Danubit, Ismail Qemali ishte personi numër dy pas qeveritarit, sepse kishte tre funksione; Drejtor për çështjet politike; Shef i Sekretarisë dhe Kryeredaktor i gazetës që dilte në frëngjisht “Le Danube”. Aty, në atë vend pune ai u dekorua me “Gradën

e Klasit të Parë”, më 22 mars 1867. (tek ne, kur do të vendosen gradat në administratë sipas meritave?!?) Në Rushçuk të Rumanisë ai u martua me vajzën e një greku të vajtur atje, me Kleoniqi Sumërlin, me të cilën në jetë pati dhjetë fëmijë, katër vajza dhe gjashtë djem. Në vitin 1869, ai u dërgua qeveritar i Varnës. Menjëherë, duke parë mizerjen ekonomike dhe shoqërore, ai mundi të mbledhë fonde dhe të hapë njëherazi disa shkolla të niveleve të ndryshme. Por Qeveritari i Përgjithshëm, duke e përgëzuar për punën e tij, i hiqte edhe një “vërejtje”: -“Çfarë do të ndodhë me ne të dy, kur të gjithë këta njerëz të jenë të mësuar, e të bëhen avokatë përtacë?” Në qeverisjen e tij, ai nuk bënte dallim mes kombeve. Përkundrazi, thoshte se “Çerkezët janë një racë me vitalitet dhe energji të jashtëzakonshme”(Ismail Kemal, fq.82). Madje ai u përpoq të vendoste në sanxhakun e tij edhe 100.000 gjermanë që donin të largoheshin nga

Rusia. Kostancës së sotme të Rumanisë, ai për herë të parë i siguroi ujin e pastër të pijshëm, duke bërë kështu të mundur, zhdukjen e një sërë sëmundjesh. Me këto vepra, ai nuk mund të shihej me sy të mirë nga sulltani. Ambasadori austriak në Athinë, baroni Fon Braun shkruante:- “Shkaku i largimit të Ismail Qemalit nga Stambolli, ishin idetë e tij patriotike, që paskan zgjuar mosbesimin e pallatit”... Ndaj, një periudhë katër vjeçare ai u pa punë, duke qenë i varfër ekonomikisht. Ajo që duhet ditur mirë, është internimi i tij. “Çuditërisht” internimi i tij përkon jo vetëm me Luftën Ruso-Turke, por edhe me Lidhjen e Prizrenit. Pastaj, me sa duket, ai nuk ishte më “i rrezikshëm”. Por atij i duhej të ruhej më së shumti nga kurthet që i ngrinin shqiptarët. Megjithatë, ai kurrë nuk pushoi së interesuari për ta, e sidomos për shqiptarët që kishin kontribut për atdheun. Kështu vlen të përmendet përpjekja e tij që liroi Hasan Tahsinin, të cilin e dërguan “vllaznit” e vet shqiptarë prapa hekurave në Stamboll. Hasan Tahsini akuzohej se pat shpallur që... “Perëndia nuk ekziston”(ai dinte shumë gjëra, se ishte shkencëtar). -“Më vjen keq që zotëria jote, një njeri i lartë, t`i verë veshin këtyre fjalëve, pasi ata që e kanë denoncuar nuk e kanë kuptuar domethënien e këtyre fjalëve. Prandaj po ju them: Shpifjet janë për njerëzit, por të mëdhenjtë nuk duhet të mashtrohen prej tyre dhe t`i besojnë”... Kështu i besoi atij Komandanti i xhandarmërisë së Stambollit dhe Tahsini fitoi lirinë. Në vitin 1891, I.Q. caktohet qeveritar i Bejrutit. Ishte i gëzuar, se aty gjeti... “Pashko Vasën, bashkatdhetarin tim... që ishte qeveritar i Libanit dhe kalonte pushimet dimërore në Bejrut”-shkruante ai. Kur shkoi në Latakia-që sot është port i Sirisë, i çliroi vendasit prej taksës dhe prej mungesës së ujit. Dokumenti më i plotë që tregon dimensionet e burrit të shtetit, është Memorandumi që iu kërkua nga ana e Sulltanit për gjendjen e perandorisë. Nuk është momenti këtu, pasi ai kërkon një analizë të thellë më vete disa orëshe, por jam i mendimit se edhe sot po ta lexonin vendim-marrësit e politikës sonë, do të gjenin elementët e duhur për gjeopolitikën në rajon dhe më gjerë. Thelbi i atij Memorandumi ishte pak a shumë: “Perandoria osmane nuk duhej të harxhonte fonde për të penguar çlirimin e popujve, por forca e saj do të konsistonte në unitetin e popujve dhe burimeve të tyre të përbashkëta, të cilat destinohen proporcionalisht për zhvillimin ekonomik të së gjithë perandorisë.”

PSE U DORËHOQ ISMAIL QEMALI?

Gjatë përpjekjeve titanike të tij për themelimin dhe mbajtjen e shtetit, Ismail Qemali pati nderin të urrehej nga tradhtarët e këtij kombi, nga të gjithë feudalët turkomanë shqiptarë si Syrja Vlora dhe Myfit Libohova e Ymer Vrioni. Kuptohet, flamurin në krye të të gjithë armiqve të tij dhe të Shqipërisë, e mbante tradhtari më i zi këtij kombi, Esat Toptani. Sa i takon faktit të karakterizimit të tij me këtë emër, le t`i besojmë një gruajë të huaj në vlerësimin për Esatin, një të anglezeje që bëri për Shqipërinë thuarje po aq sa do të duhej

të bënin të gjithë "pashallarët" dhe "bejlerët" shqiptarë që tundeshin me ofiqet dhe çifligjet që kishin marrë shpërblim për besnikërinë e treguar ndaj sulltanit. Edit Durhami e cila në 19 Qershor të vitit 1913, e shoqëruar nga një gazetar anglez, i bëri një vizitë tradhtarit në Tiranë. Edit Durhami në librin e saj "Histori të Esat Pashës" në faqen 207, shkruante: -"Ai më ngjan me kondotierët italianë të shekujve XV dhe XVI, të cilët së bashku me ushtritë e tyre viheshin në shërbim të secilit kryetar që i paguante më shtrënjtë, pa marrë parasysh dëmet e mëdha që i shkaktonin vendit. Si ata, edhe Esati nuk kishte as ndjenja kombëtare, as karakter, as nder. Ai ishte një njeri i zhveshur nga çdo skrupull. Nuk ngopej me pasuri dhe pushtet, aq sa edhe të afërmit e tij e urrenin për këtë."

Edhe "vllau" i tij, Syrjau, i dërgonte letër Sulltanit: "Më emëro vali të Beratit dhe Vlorës, që të pengoj Ismailin për t'u lidhur me Italinë dhe Austro-Hungarinë"... Po ky njeri i shkruante në Nëntor të vitit 1913, se... "Ismail Qemali duhet të largohet nga qeverisja, pasi duhej bërë bashkimi i vendit nën Esat Toptanin"!!! (AQSH, Fondi 58, Dosja 28)

Në vitin 1913 Ismail Qemali i pat deklaruar anglezit Obrejti Herberitit autorit të librit "Ben Këndim": -"Unë dua vetëm që atdheu im të ngulij këmbët dhe pastaj do të jap dorëheqjen. Jam i lodhur, shumë i lodhur". Pati edhe kritika konstruktive nga patriotët atdhetarë për qeverisjen. Kështu për shembull Mihal Grameno e Themistokli Gërmenji në shkrimet e tyre për sa i takonte qeverisjes, kishin vërejtje sa u takonte pagave relativisht të larta të nëpunësve për atë kohë, por edhe për nevojën e ngutshme që pjesa dërrmuese e të ardhurave që grumbulloheshin, të shkonin në arsim, në ushtri dhe në veprat publike. Ashtu siç kishin vërejtje edhe për disa vende pune të cilat mund të mos ishin, pasur parasysh atë ç'ka ofronin ata që merrnin rrogat. Ky ka qenë dhe duhet të jetë roli i intelektualëve patriotë në të gjitha kohërat, që ata të jenë oponencë e qeverisjes, ta kritikojnë atë për të punuar më mirë. Ishte shpallur ndërkohë prej muajsh edhe Vendimi i Konferencës së Ambasadorëve. Më datën 22 Janar të vitit 1914 Ismail

Qemali dha dorëheqjen. Në tekstin e dorëheqjes nënvizohet: "Duhet t'i dorëzohet pushteti Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit". Para gjithë ministrave të kabinetit të tij, ai iu drejtua përfaqësuesit të KNK: "Merrni përsipër këtë detyrë dhe pushtetin në dorëzim". Qysh prej vitit 1914 e deri sa vdiq, Ismail Qemali qëndroi jashtë shtetit. E nuk mund të ndodhte ndryshe. Një njeri i mençur si ai, nuk mund të qëndronte mes bejlerëve turkoshakë e tradhtarë, mes atyre që të vrisnin natën dhe të qanin ditën. Më 28 Janar 1919, në krye të detyrës së patriotit ndaj atdheut të vet, Ismail Qemali vdiq në Peruxhia të Italisë. Diagnoza e vendosur, bënte fjalë për një hemorragji cerebrale.

Ndoshta paraqet interes për studim, libri i Fatushe Shehdulaj, me titull: "Mbi aktivitetin patriotik të Ali Ylli (Pajtanit). Për faktin se autorja ka qenë edhe dëshmitare okulare e asaj dite, në të njëjtin hotel ku vdiq Ismail Qemali. Aty autorja thotë: -"Sapo mbërrita në Itali, dëgjova shërbyesin e Ismail Qemalit të bërtiste: "Plakun patriot e helmuan në kafene. Ai sapo piu kafen, ndje dhimbje të forta në stomak dhe thirri: -Më helmuan! Pas pak vdiq." Nëse mbajmë parasysh se ishte pragu i marrëveshjes Titoni-Venizello që do të projektonte copëtim të mëtejshëm të trojeve shqiptare, e që Ismail Qemali ishte një shkëmb i fortë para tyre, nuk duhet përjashtuar mundësia e vrasjes së tij. Por ç' rëndësi ka kjo? Ai jetoi plot 75 vjet e 12 ditë. Para varrit të tij në Vlorë shkon dhe përulet me respekt një komb i tërë. Por është tanimë edhe me Ligj, portreti i tij, ai që hijeshon muret e zyrave të shtetit, me cilësinë e themelesit të tij... Ndërsa eshtrat e armikut të tij dhe tradhtarit të kombit Esat Toptani, plehërojnë varrezat e Beogradit e sot nuk i gjendet varri. Sepse punëdhënësit e tij serbë u kujdesën qysh në vitin 1926, ende pa u tretur mirë, ta sillnin kufomën e tij nga Parisi në Beograd. Beogradi e rivarrosi me nderime shtetërore shërbëtorin e tij, me në krye Pashiqin. Pashiqi në dhimbjen për humbjen e shërbëtorit të zellshëm, ndjehej i qetë, pasi sapo kishte emëruar kryeministër në Shqipëri, vetë nipin e Esatit...

Në shumë vende të Evropës, ekzistojnë dy vargje për kategorinë e tradhtarëve: "Tradhtarët një fund kanë / Varrin që u humbet varrë"!...

Atasheu Britanik n/kolonel Richard Perry, në krye të një ekipi shoqërues, viziton Akademinë e Nënoficerëve

ANO, në fokus arsimi dhe bashkëpunimi me britanikët




Në kuadër të bashkëpunimit midis Akademisë së Nënoficerëve "Thomson" dhe FA britanike, Atasheu Britanik, n/kolonel Richard Perry, në krye të një delegacioni shoqërues, vizitoi Akademinë e Nënoficerëve "Thomson". Zv/komandanti dhe aktualisht komandanti në detyrë i ANO, n/kolonel Muhamed Guza, priti në një takim të veçantë atasheun britanik dhe ekipin që e shoqëronte. Në takim morën pjesë shefi i Shtabit të KDS-së kolonel Riza Zaja, si dhe personeli drejtues i kurseve dhe degës arsimore që zhvillohen në ANO. Pasi ju uroi mirëseardhjen, zv/komandanti dhe aktualisht komandanti në detyrë i ANO, n/kolonel Muhamed Guza, falenderoi ekipin britanik për interesin e treguar në rritjen e bashkëpunimit të FA britanike me ANO, duke theksuar se angazhimi nga ana e institucionit që ai drejton, për përmbushjen e detyrimeve përkatëse, në drejtim të rritjes dhe zhvillimit të trupës së nënoficerëve të FARSH, do të jetë maksimal. Nga ana e tij, shefi i Shtabit të KDS-së, kolonel Riza Zaja, siguroi ekipin britanik për mbështetje maksimale të institucionit të ANO, nga ana e Komandës së Doktrines dhe Stërvitjes, si institucioni kryesor e përgjegjës për fushën e arsimimit ushtarak, për të gjithë personelin oficer, nënoficer e ushtar profesionist të FARSH. Takimi vijoi me diskutime të përbashkëta dhe shkëmbim idesh, të fokusuar kryesisht mbi procedurat që ndiqen që nga rekrutimi i Ushtarëve Profesionist, ndjekja e kurseve në ANO, mënyrat dhe fazat e përzgjedhjes për promovim

për gradat pasardhëse; procedurat që ndiqen për përzgjedhjen e instruktorëve të ANO-së, vlerësimi i performancave të treguar gjatë kohës së trajnimeve, roli e vendi që zë figura e nënoficerit në FA, raporti me personelin oficer, etj. Ajo që u evidentua gjatë këtyre diskutimeve ishte fakti se metodat dhe teknikat e ndjekura nga ANO, në drejtim të trajnimit dhe arsimimit të kursantëve si dhe për përzgjedhjen dhe vlerësimin e punës së instruktorëve, ishin pothuajse të njëjta me ato që ndjek pala britanike. Gjithashtu, theksi u vu dhe në lirinë që duhet i jepet nënoficerit për të marrë përgjegjësitë që i takojnë, për të zbatuar një detyrë të caktuar, faktor ky mjaft i rëndësishëm dhe produktiv në zhvillimin e trupës së nënoficerëve, si dhe


në përmbushjen e misionit të FA në tërësi. Për rreth 15 minutash, ekipi britanik si dhe pjesëmarrësit në takim, ndoqën zhvillimin e një ore mësimi të drejtuar nga kapter Hamza Shahini në lëndën e lider-shipit, me një grup të Kursit Bazë të Nënoficerit. Konkluzionet dhe detajet e mëtejshme të takimit, u bënë ditën e dytë të zhvillimit të tij, ku pala britanike u shpreh me tone pozitive në drejtim të zhvillimit të procesit të arsimimit, e mënyrës së funksionimit të këtij procesi në ANO. Nga ana e tyre u evidentua se në procesin e këtij bashkëpunimi, nuk do të mungojë transparenca dhe dhënia e asistencës për nevojat që Akademia e Nënoficerëve ka, si në trajnimin e personelit të saj, shkëmbimin e eksperiencave etj.

N/Togere Morena Halilaj



1958, raporti i parë i Inteligjencës së SHAPE mbi nëndetëset e Vlorës

Shqipëria e Luftës së Ftohtë në dokumentet Sekrete të NATO-s



ALBERT HITOALIAJ

ORIGINALI: ANGLISHT
9 shtator 1958
SECRET NATO
RDC / 28/317

Për: Sekretarët e Delegacioneve
Nga: Sekretar Ekzekutiv

SHAPE. Raport i Inteligjencës

Materiali në vijim është marrë nga Përfaqësuesi i Grupit të Përhershëm dhe është shpërndarë për informim të Delegacioneve:

“Në vijim është një ekstrakt nga një Raportit Përmbledhës i kohëve të fundit i Inteligjencës së SHAPE-s, dhe është sjellë për informimin tuaj:

1. Një skuadron Sovjetik i klasit të anijeve transportuese 1 ATREK (me flamurin e një zyrtari të lartë të imbarkuar) dhe katër nëndetëse të klasit-W ka dalë nga Baltiku, duke hyrë në Mesdhe dhe është tani qartësisht në rrugën e saj drejt Shqipërisë. Kur u raportua së fundi, herët në mëngjesin e 31 gushtit, ajo ishte 30 n.m. në jug të Otrantos, duke e ecur në Veri-Lindje me 10 nyje.

2. Një grup ndihmës sovjetik (një rimorkiator, një vinç lundruar, një anije kabull-hedhëse, dy cisterna) ka dalë nga Baltiku dhe tani po lundron nëpër Mesdhe. Kur u raportua së fundi, në pasditen e 27 gushtit, ai ishte 30 n.m. lindje të Gjibraltarit, duke lëvizur drejt Lindjes.

3. Një anije ushtarake transporti sovjetike dhe një rimorkiator kanë dalë nga Deti i Zi dhe tashmë raportohet që të jenë në Gjirin e Vlorës. Ata duhet të kthehen në Detin e Zi më 9-10 shtator.

Komentit nga SHAPE: Ky duket të jetë një moment i përshtatshëm për BRSS, për të vënë nën presion

si Jugosllavinë edhe Perëndimin, ndoshta nëpërmjet vend-bazimit, të përkohshëm, të disa nëndetëseve në Shqipëri. Mënyra e hapur dhe mbi-bord, sipas së cilës është bërë kjo lëvizje, vihet re për sa u tha në këtë drejtim. Kjo është hera e parë që na ka ardhur në dorë një informacion i besueshëm i qëndrimit të nëndetëseve sovjetike në Shqipëri. Lëvizjet e transportuesve ushtarake dhe rimorkiatorit mund të jenë të lidhura me mbështetjen logjistike të këtyre nëndetëseve. Gjithashtu, mendohet të jetë e mundur, edhe pse nuk ka ende informacion në dispozicion për ta mbështetur këtë gjë, se lëvizja e grupit të ndihmësve sovjetikë mund të jetë i lidhur me logjistikën për këto nëndetëse.

(Nënshkruar) Coleridge

SECRET NATO

Dokumenti Origjinali

ORIGINAL: ENGLISH
9th September, 1958
NATO SECRET
RDC / 28 / 317

To: Secretaries of Delegations
From: Executive Secretary

SHAPE Intelligence Report

The following has been received from the Standing Group Representative and is circulated for information of Delegations:

“The following is an extract from a recent SHAPE Intelligence Summary Report, and is furnished for your information:

1. A Soviet squadron of 1 ATREK-class depotship (with a senior flag officer embarked) and four W-class

submarines has exited from the Baltic, entering the Mediterranean and is now obviously on its way to Albania. When last reported early on the morning of 31 August, it was 30 n.m south of Otranto, making NE at 10 knots.

2. A group of Soviet auxiliaries (1 tug towing a floating crane, 1 cable-ship, 2 oilers) has exited from the Baltic and is now sailing through the Mediterranean. When last reported on the afternoon of 27 August, it was 30 n.m. east of Gibraltar, steaming east.

3. A Soviet, military, transport and one tug have exited from the Black Sea and are now reported to be in Valona Harbour. They are due to return to the Black Sea on 9-10 September.

SHAPE comment: This seems to be an opportune moment for the USSR to put pressure both on Yugoslavia and the West by stationing possibly, temporarily, some submarines in Albania. The open and above-board way in which this movement has been made is remarkable in this respect. It is the first time that any reliable information of the stationing of Soviet submarines in Albania, has come to hand. The movements of the military transports and tug may well be connected with the logistic support of these submarines. It is also thought possible, though no information is as yet available to support this, that the movement of the group of Soviet auxiliaries may be connected with the logistics for these submarines.

(Signed) COLERIDGE

NATO SECRET

NJOFTIM

PËR HAPJE TË KURSIT TË 9-të TË FORCAVE SPECIALE NË BATALIONIN SPECIAL TË FORCAVE TOKËSORE

Kandidatët që do të aplikojnë për të marrë pjesë në kursin e 9-të të Forcave Speciale, të paraqiten për të dorëzuar dokumentacionin përkatës pranë Seksionit të Personelit (S1) në Batalionin e Forcave Speciale, me adresë “Zall-Herr” Tiranë, ku do të njihen me rregulloren, kriteret, procedurat e testimit, etj.

Regjistrimi për kursin e 9-të të Forcave Speciale bëhet vetëm për kandidatët ushtarakë aktivë në FA. Regjistrimi përfundon në datën 27.01.2014 ora 12.00 dhe zhvillohet pranë Seksionit të Personelit (S1) në Batalionin e Forcave Speciale. Data e zhvillimit të testeve për kandidatët do të jetë data 03-14 shkurt 2014 në ambientet e Batalionit Special në Zall-Herr, Tiranë.

• *Kriteret për regjistrimin e kandidatëve:*

1. Të jetë ushtarak aktivë në FA (Oficer, n/officer, ushtar profesionist)
2. Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë.
3. Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm në të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformatojnë pamjen.
4. Të mos jetë bartës i virusit HIV dhe Hepatit B; të mos ketë kaluar sëmundje të zemrës, veshkave, mëlçisë dhe mushkërive.
5. Të jetë me gjatësinë trupore, mbi 175 cm.
6. Të ketë minimum 1-3 vjet ushtarak aktiv në FA.
7. Për kandidatët Oficer të ketë nivel të gjuhës angleze niveli 2/2/2 sipas STANAG 6001 ose 70 pikë ALCPT.
8. Për kandidatët N/Oficer të ketë nivel të gjuhës angleze niveli 1/2/2 sipas STANAG 6001 ose 60 pikë ALCPT.
9. Për kandidatët ushtarët profesionistë të ketë nivel të gjuhës angleze niveli 1/2/2 sipas STANAG 6001 ose 60 pikë ALCPT.

• *Për oficerët*

- a. Të jetë nga grada N/Toger deri në Kapiten.
- b. Mosha maksimumi 27 vjeç.

• *Për n/officerët*

- a. Të jetë nga grada N/Tetar deri në Tetar.
- b. Mosha maksimum 27 vjeç.

• *Për ushtarët profesionistë*

- a. Mosha maksimum 27 vjeç.
- b. E preferueshme të kenë përfunduar kursin fillestar.

• *Kandidatët duhet të paraqesin këto dokumente:*

1. Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati, në të cilën të jetë shkruar arsytet e futjes në kursin special.
 2. Certifikatë origjinale për gjuhën angleze (nëse e ka) nëse s’ka do testohet në Batalionin e Forcave Speciale.
 3. Fotokopje e kartës së identitetit.
 4. Certifikatë familjare, 1 copë.
 5. Fotografi për dokument, 2 copë (4x6 dhe 9x12).
 6. Të dhënat e personelit sipas formatit ushtarak, të firmosura nga shefi i personelit të njësisë ku shërben (CV).
 7. Kopje/vërtetim nga personeli mbi praktikën disiplinore të kandidatit.
- Gjithashtu njoftohen të gjithë aplikantët të cilët kanë dorëzuar dokumentacionin përkatës për regjistrim në kursin e 9-të të Forcave Speciale, të kontaktojnë me zyrën e personelit në për të rikonfirmuar pjesëmarrjen në të kurs.

Për çdo informacion në lidhje me kriteret e pranimit dhe testimit, pikë kontakti:

Pikë kontakti 0688014344
florjan.bamkallari@aaf.mil.al
Adresa: Zall-Herr, Tiranë

BATALIONI SPECIAL I FORCAVE TOKËSORE

Përse ti duhet të jesh pjesë e batalionit të Forcave Speciale:

1. karrierë ushtarake të garantuar për personelin ushtar profesionist dhe n/officer, pasi të gjitha funksionet organike në BFS janë për n/officerë dhe pjesa më e madhe e tyre janë të gradës tetar- rreshter- kapter.
2. të ndihesh krenar për veten tënde, bëj diçka që të tjerët nuk kanë mundësi fizike dhe intelektuale ta bëjnë. motoja jonë është “më mirë të vdesim për diçka sesa të jetojmë pa bërë asgjë”.
3. trajnim dhe stërvitje e njëjtë me ato të standardeve të forcave speciale të vendeve aleate të NATO-s.
4. ti ke mundësi të kapërcesh kapacitetet e tua, ti mund të bësh më tepër për veten dhe për vendin tënd.
5. ti do të kesh mundësi të punosh me personel me përvojë të jashtëzakonshme, shumë prej të cilëve kanë nivel shumë të lartë profesional dhe do të trajnohesh në më shumë se një specialitet, pra ti mund të aftësohesh në shumë specialitete, (zhytës, anti-terror, parashutist apo alpinist).
6. ti do të trajnohesh nga instruktorët më të mirë të forcave speciale të vendit tonë por gjithashtu dhe të vendeve aleate. do të marrësh njohuri të cilat do të kesh mundësi ti vesh në përdorim kudo në jetë.

Krijimi BrVI Sulmuese, “Hero i Popullit”

Takim përkujtimor për krijimin e BrVI S “Hero i Popullit”

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Në kuadër të 70 vjetorit të krijimit të BrVIS “Hero i popullit” më datën 24.01.2014, në ambientet e Muzeut Historik Kombëtar u zhvillua takimi përkujtimor i cili u hap nën tingujt e Himnit Kombëtar dhe Marshit të BrVIS. Takimi u drejtua nga Bashkim Gjolliku, i biri i ish-komandantit të BrVIS. Në këtë takim përkujtimor përshëndetën në emër të ish-partizanëve të BrVIS ish-kuadri i kësaj brigade Resul Bedo. Përshëndetën gjithashtu, kryetari i Organizatës së Veteranëve të LANÇL të popullit shqiptar Rustem Peçi, pati një përshëndetje të veçantë nga Organizata Kombëtare për Dëshmorët e LANÇ dhe Dëshmorëve të tjerë të Atdheut dhe në fund përshëndeti edhe drejtori i Shtëpisë së Kulturës “N. Frashëri” së Përmetit, atje ku 70 vjet më parë u mblohdën 912 partizanët e katër batalioneve partizane dhe ku u formua Brigada partizane. Takimi përcollti mesazhe përjetësie për veprën heroike të partizanëve shqiptarë gjatë LANÇ në përgjithësi si dhe 1245 partizanëve të BrVIS “Hero i popullit” në veçanti si dhe nderim e përkujtim të përhershëm të 220 dëshmorëve të rënë për lirinë e atdheut. Takimi përkujtimor sollti kujtime nga dita e parë e rreshtimit të BrVIS që kishte 912 partizanë, e deri në ditën e fundit të luftës, ku në beteja kanë rënë 220 dëshmorë nga të cilët 57 dëshmorë jashtë kufijve të Shqipërisë. Ndërsa ditën e shtunë më datën 26.1.2014, një grup ish-partizanësh, veteranë, pasardhës veteranësh dhe familje të dëshmorëve të BrVIS shkuan në Përmet, ku brigada u rreshtua për herë të parë dhe nderoi të rënë tek monumenti “Partizani çlirimtar”.

Br VI S - Brigada e parë partizane në qarkun e Gjirokastrës

Br VI S “Hero i popullit” u krijua më 26.1.1944 në Përmet. Përbëhej nga batalionet partizane “Asim Zeneli”, “Abaz Shehu”, “Baba Abaz”, “Naim Frashëri”, një kompani e batalionit “Çamëria” si dhe batalioni “Zaho Koka”. Kishte 912 luftëtarë në ditën e parë të saj. Në kulmin e veprimeve luftarake brigada numëronte 1700 partizanë. Pjesëmarrës në luftime për çlirimin e 8 qyteteve dhe 32 krahinave. Br VI S pati 220 të rënë dëshmorë nga të cilët 57 ranë jashtë kufijve të Shqipërisë si dhe mbi 500 të plagosur. Përshkroi një itinerar prej 3500 kilometra. BrVIS kishte 10 heronj të popullit: Mustafa Matohiti, Jaho Gjolliku, Mitro Xhani, Lefter Talo, Fato Berberi, Bule Naipi, Persefoni Kokëdhima, Meleq Gosihshti, Çelo Sinani, Avdul Hakiu. Nga 110 vajza pjesëmarrëse 10 janë dëshmore dhe tre heroina të Popullit. Në LIIB morën pjesë 61 shtete nga pesë kontinente dhe fashistët varën në litar 6 femra, 5 nga të cilat ishin shqiptare; 3 ishin nga Brigada e gjashtë. Br VI S është drejtuar nga komandanti i Brigadës Tahir Kadareja, zv/komandanti Jaho Gjolliku, komisar Mustafa Matohiti, zv/komisar Haki Toska, shefi i Seksionit Politik Adil Çarçani, i cili më vonë mori përgjegjësi të reja në formacionet më të larta partizane etj. Komandantë e komisarë batalionesh: Komandant të batalionit të parë: Riza Veipi dhe Ago Çeli; të b2p: Sadik Buzo dhe



Avdul Hakiu; të b3p: Fejo Ismaili dhe Asaf Dragoti, të b4p: Feti Bubësi dhe Petrit Radovicka. Një nderim të veçantë u drejtohet në këtë 70 vjetor të BrVIS, atyre që kontribuan për shkrimin e historikut të BrVIS si: Xhemil Frashëri, Resul Bedo, Sevo Tarifa, Mersin Mixha, Lame Çekani, Esat Golemi, Malo Hashorva, Xhule Çiraku, Janul Dan-go, Jaup Dabulla, Kapo Kapaj, Hidai Hidaj, Avni Gjoni, Resul Galanxhi, Avdul Dobi, Sami Hadëri, Zagoll Skëndaj etj.

Drejtesit më të lartë të BrVI S

Komandanti i BrVIS, Jaho Gjolliku - lindi në Kuç të Kurveleshit. Figurë e shquar e patriotike e LANÇ. Pjesëmarrës në të gjitha evenimentet shqiptare, në 1912 në Pavarësinë e Vlorës, në Revolucionin e 1924-ës, në kryengritjen e 1935 në Fier, në LANÇ që në fillimet e saj. Pjesëmarrës në të gjitha luftimet e BrVIS, në çlirimin e 8 qyteteve dhe 32 krahinave. Luftoi me trimëri në Gjorm, Sarandë, Këlcyrë, Borsh, Përmet, Pukë, Dukagjin, Mirditë, Vishegrad etj. Ndërron jetë në 27 dhjetor 1969 dhe pas vdekjes i jepet titulli i lartë “Hero i Popullit”. Komisar i BrVIS, Mustafa Matohiti - Figurë e shquar e patriotike, i cili që nga viti 1934-1935 dha kontributin e madh në organizimin e lëvizjes komuniste, për organizimin e luftës NÇL në krahinën e Kurveleshit, Përmetit e Delvinës, për të cilat dha jetën më 29 mars 1944, u vra gjatë luftimeve të pabarabarta me forcat gjermane. Zv/komisar i BrVIS, Haki Toska, lindi në Gjirokastrë, gjatë Luftës së Dytë Botërore, ishte zëvendëskomisar i brigadës së 6-të. Për shumë vite ka qenë funksionar i lartë i PPSH-së duke u bërë deri sekretar i saj. Ndër detyrat ekzekutive më të rëndësishme të Haki Toskës kanë qenë ajo e zv/kryeministrit në periudhën 16.9.1966 deri 18.11.1970 dhe ajo e ministrit të Financave në qeverinë e fundit të Mehmet Shehut në periudhën 27.12.1978 deri 17.12.1981.

Rruga luftarake e BrVIS

Lufta Nacionalçlirimtare e shqiptarëve ishte nderi dhe krenaria shqiptare. Lufta e partizanëve shqiptarë ishte me qëllime të pastra për lirinë e pavarësinë e Shqipërisë, për ruajtjen e paprekur të pavarësisë shqiptare. LANÇ ishte



pjesë e përbashkët e luftimit antifashist botëror e renditur bashkë me rusët, anglezët e amerikanët. Në hapësirën shqiptare vepruan 24 brigada partizane dhe njëra nga këto ishte BrVIS, që për nga aktiviteti luftarak, trimëria dhe kontributi për çlirim ka merituar titullin “Hero i Popullit”. Rruga luftarake e BrVISulmuese. BrVISulmuese, e krijuar në qytetin e djegur të Përmetit, që në fakt ishte një inaugurim në llogoret e luftës për të 912 luftëtarët e parë të saj më 26 janar të vitit 1944. Brigada u grumbullua, por nuk u inaugurua. BrVIS përbëhej nga batalionet partizane “Asim Zeneli”, “Abaz Shehu”, “Baba Abaz”, “Naim Frashëri”, një kompani e batalionit “Çamëria” si dhe batalioni “Zaho Koka”. Komandanti i parë i Brigadës ishte Tahir Kadareja, zv/komandant Jaho Gjolliku, komisar Mustafa Matohiti, zv/komisar Haki Toska, shefi i Seksionit Politik Adil Çarçani, por dhe gjithë partizanët e BrVIS. Batalionet që përbënin brigadën e porsaformuar partizane nuk i ndërprejnë luftimet. Ato zunë pritë dhe pusitë dhe ditën të organizohen edhe përballë një operacioni masiv të ushtrisë gjermane “Horridoh” (thirrje për të çuar gjahun). Luftime të përgjakshme që zgjatën gjashtë ditë në Përmet bënë që batalionet partizane ta përbaltonin me zhdërvjelltësi goditjen e organizuar të nazistëve. Në vijimësi në riorganizim e sipër u përbaluan edhe luftime të përgjakshme në shumë zona të tjera jugore si në luftimet në Këlcyrë e Përmet, në Lunxhëri, në luftën e Libohovës, në Gjirokastrë, Kardhiq, Fushëbardhë, Rëzomë, Kurvelesh. Gjithashtu krisma e luftës u dëgjua për BrVI sulmuese edhe në zonat e Delvinës, Mesaplikut, Borshit, Patosit, në Labinot, në zonën e Tiranës, në Shupal e më tej dhe në Mirditë,

Pukë, Dukagjin, e deri në Shkodër. Është fakt se në përbërje të BrVIS ka pasur një pjesëmarrje masive të bektashinjve në LANÇ. Kështu përshembull nga të 26 teqetë që kishte Tepelena, të 26 drejtuesit e tyre u bashkuan me partizanët në batalionin “Baba Abaz” dhe që vërtetonte thelbin e një prej parimeve të bektashizmit se “pa atdhe nuk ka fe”. BrVI sulmuese ishte cilësuar nga pushtuesit “vdekja e zezë”. Kjo brigadë shpartalloi me sukses operacionin “magjia e pranverës”. Me trimërinë zhdërvjelltësinë dhe manovrueshmërinë në fushëbetëje Brigada e gjashtë ruajt forcat e saj dhe i shkaktoi kundërshtarit humbje në forca dhe në mjete e teknikë luftarake. Është për t’u shënuar beteja e përgjakshme në Dukaj të

Tepelenës, lufta në Labinot të Elbasanit etj. Brigada e VI ishte pjesë e veprimeve luftarake për çlirimin e Shkodrës, që ka qenë edhe pjesë e debateve politike për gati dy dekada. Pasi erdhëm nga veriu i Shqipërisë si Nikaj-Mërturi, Shoshaj, e me radhë ne u vendosëm në zonën që kalohej për në Tuz me qëllim që të mos shkonin gjermanët për aty, në qoftë se do largoheshin. Në atë kohë në Shkodër ishin forca të shumta gjermane. Në zbatim të urdhrit të Shtabit të Përgjithshëm BrVIS duke qenë në pararojë, të Armatës së III Internacionale, bashkë me formacione të tjera të mëdha partizane kaloi kufirin shtetëror duke kaluar zonat e ashpër malore dhe me dëborë me qëllim për të ndjekur armiqtë me luftime të pandërprera në territorin e Malit të Zi dhe të Bosnjës. Ky ishte një mision tepër i rëndësishëm në kuadër të misionit të koalicionit të madh antifashist botëror. Kështu pas çlirimit të Shqipërisë brigada e vazhdoi misionin në drejtim të Hotit, Grudës, Tuzit, Titogradit, e deri në thellësi të Bosnjës e Vishegrad. Luftime të përgjakshme ka zhvilluar brigada jashtë kufijve veçanërisht në zonat e Verushës, Velareka Suhagorës, Drinskos, e Vishegradit. Beteja për Vishegradin ishte beteja e fundit më 14 shkurt 1945 për nga radha e betejave të përgjakshme të Brigadës së gjashtë sulmuese, megjithëse misioni nuk kishte përfunduar. Me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm BrVIS, pas Vishegradit brigada u kthye në Kosovë për të vendosur gjendjen, pasi aty serbët kishin bërë mjaft masakra. Dita e fitores përfundimtare mbi fashizmin i gjeti partizanët e BrVIS në Kosovë. Qëndrimi jashtë kufijve të BrVIS zgjati deri më

9.6.1945 kur erdhi urdhri nga shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH për kthim në atdhe. Më 11.6.1945 partizanët e BrVIS parakalojnë në Shkup dhe një ditë më vonë mbërrijnë me tren pranë Manastirit. Edhe përpara popullit të manastirit parakalojnë më 18.6.1945 dhe mbrijnë në Ohër në 19.6.1945. Transportimi i brigadës nga Ohri është bërë me makina për në atdhe me mision plotësisht të kryer. Është fakt se lufta e viteve 1939 - 1945 me pjesëmarrjen e 61 shteteve të botës, me pjesëmarrje 110 milion ushtarë e civilë nga 5 kontinente me shtrirje në 41 shtete. Konflikti u zhvillua në tre kontinente: Evropë, Azi e Afrikë, por politikisht, moralisht e materialisht u përfshi dhe kontinenti i Amerikës. Por BrVISulmuese, me luftën dhe heroizmin në fushëbetëje shkruan epope me gjakun e 220 dëshmorëve të saj që prehen sot në altarin e lirisë së kombit. Ata ranë në betejat partizane nga jugu në Veri të Shqipërisë. Në këto beteja nga BrVIS u derdh gjaku për lirinë e Shqipërisë, dhe të trojeve shqiptare jashtë saj. Dëshmorët sot flasin me zërin e lirisë dhe me zërin më sublim të Atdheut. Kështu përmendim edhe Fato Berberi, Bukurie Bazo, Latife Nora, Persefoni Kokëdhima, Fete Gjini, Xhevaire Braka, Mustafa Matahiti, etj., që kanë zënë vend që në numrat e parë “Flaka”, që u botua në vjeshtën e viti 1944 si organ politiko-ushtarak i BrVIS. Çlirimi i Shqipërisë është vullosur përfundimisht nga partizanët shqiptarë, fitimtarët e LANÇ.

Shqiptarët në koalicionin e madh antifashist botëror

Shqipëria në vitin e fillimit të luftës ishte një vend i vogël për nga përmasat dhe popullsia me më pak se 1 milion banorë. Ajo aderoi në koalicionin e madh antifashist BRSS - SHBA - Angli në dhjetor 1942. Kështu Shqipëria për herë të parë u përfshi në një front botëror luftë të drejtë në krahun e fitimtarëve të mëdhenj dhe kjo luftë e popullit shqiptar u konceptua si vazhdim i drejtpërdrejtë i luftërave për liri e pavarësi. Pas çetave partizane u krijuan batalionet partizane në çdo krahinë, kështu në prag të krijimit të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH në radhët e forcave partizane ishin rreshtuar 10000 partizanë dhe 20000 të tjerë ishin rreshtuar në radhët e çetave territoriale vullnetare të teritorit e çliruara dhe në njësitet guerile në zonat e pushtuara nga armiku. Më 4 korrik 1943 në Labinot të Elbasanit Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar vendosi formimin e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH duke caktuar 12 anëtarë të tij, të cilët ishin: Spiro Moisiu, Enver Hoxha, Myslim Peza, Haxhi Lleshi, Mustafa Xhani, Ramadan Çitaku, Abaz Kupi, Ymer Dishnica, Dali Ndreu, Mustafa Gjinishi, Sejfulla Malëshova, Bedri Spahiu. UNÇSH pas 10 Korrikut 1943 kishte rreth 70 mijë trupa të inkuadruar në 24 brigada sulmuese, 8 divizione sulmuese, 3 korparmata. Pas krijimit të Shtabit të Përgjithshëm u krijuan njësitë e rregullta partizane si brigada, divizione dhe korparmata dhe tashmë Shqipëria kishte një forcë të rregullt të armatosur me organizim ushtarak, si gjithë ushtritë e koalicionit antifashist në LIIB.



FUQIA E SHPRESESËS

Ata u takuan për herë të parë në Francë. Në vitin 2009, në plazhin Omaha, Normandi, në Francë, rreshteri Remsburg ishte pjesë e një trupe të përzgjedhur të "Army Ranger", të cilët ishin zgjedhur që të hidheshin me parashutë për festimet e kryera për 65 vjetorin e D-Day, të Luftës së Dytë Botërore. Herën e dytë që u takuan, në një distancë kohore më të shkurtër se një vit, Presidenti Obama, shtangu kur e pa. Rreshteri të cilin e kishte takuar dikur në Francë tashmë kishte marrë dëmtime të rënda në tru pas një plagosje në Afganistan dhe ishte paralizuar pjesërisht. Hera e tretë ishte para dy javësh në Phoenix, gjatë një vizite private të Presidentit të rreshteri Remsburg. Rreshteri bëri diçka që as mjekët e as Presidenti Obama nuk do ta besonin apo parashikonin: u ngrit në këmbë dhe nderoi Shefin e tij. Ky lajm po bën "xhiron" e internetit, si për faktin se sugjestionimi ka fuqi të jashtëzakonshme, edhe për faktin se natyra e ushtarakëve ka përbërë gjithnjë një kategori të veçantë ndërmjet profesioneve të tjerë.